



Rrjeti - NATYRA 2000

# PRAKTIKAT MË TË MIRA PËR KRIJIMIN DHE MENAXHIMIN E ZONAVE NATURA 2000

Përgatitur nga: MSc. Daniela Mane

Tiranë, qershor 2022





Rrieti - NATYRA 2000



**Publikuar nga:**

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

Rr. Islam Alla, Pall. IVEA, kati i 1, Tirana

Tel/fax: +355 42231437

<http://www.inca-al.org>

E-mail: [info@inca-al.org](mailto:info@inca-al.org)

Të drejtat e autorit © Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri, 2022

Ky botim u realizua nga projekti “Fuqizimi i OJQ-ve Shqiptare për të mbështetur krijimin dhe menaxhimin e rrejtit Natyra 2000 në Shqipëri / Mbrojtja e Biodiversitetit” në kuadër të Green-AL, një projekt i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA) me fondet e Qeverisë Suedeze. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit

**Hartimi i këtij dokumenti u udhëhoq nga:**

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri - INCA

Projekti “Green-AL”

Kopjet e këtij botimi janë mundësuar nga:

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

Rr. Islam Alla, Pall. IVEA, kati I, Tiranë,

**Tiranë, qershor 2022**



Rrjeti - NATYRA 2000



## Përmbajtja

Praktikat më të mira për krijimin dhe menaxhimin e zonave Natura 2000.....	5
1.1 Rrjeti Natura 2000.....	5
2 Menaxhimi i Ligatinave .....	5
2.1 Të përgjithshme .....	5
2.2 Shembull 1: Një qasje e integruar për menaxhimin e ligatinave Amvrakikos në Greqi.....	6
2.2.1 Të përgjithshme .....	6
2.2.2 Një qasje e integruar ndaj menaxhimit.....	7
2.2.3 Vlera demonstruese .....	8
2.2.4 Efekti nxitës.....	9
2.3 Rehabilitimi i ligatinave në stepat Hortobagy, Hungari .....	9
2.3.1 Të përgjithshme .....	9
1 .....	10
2.3.2 Punimet e Restaurimit .....	10
2.3.3 Rifillimi i mbikullotjes tradicionale.....	11
2.3.4 Monitorimi dhe qendrushmeria ekonomike.....	12
3 Pyjet .....	12
3.1 Të përgjithshme .....	12
3.2 Ruajtja e llojeve pyjore të rrezikuara në Apennine, Itali.....	14
3.2.1 Të përgjithshme .....	14
3.2.2 Rëndësia e projekteve LIFE .....	15
3.2.3 Ridrejtimi i menaxhimit të pyjeve .....	15
3.2.4 Trajnime dhe ndergjegjesim .....	16
3.3 Restaurimi i pyjeve fletorë në Parkun Kombëtar Söderåsen, Suedi .....	17
3.3.1 Të përgjithshme .....	17
3.3.2 Testimi dhe zbatimi i metodave inovative .....	17
4 Mjedisi detar .....	18



Rrieti - NATYRA 2000



4.1	Të përgjithshme .....	18
4.2	Ruajtja e fokave ne Greqi.....	19
4.2.1	Të përgjithshme .....	19
4.2.2	Identifikimi dhe ruajtja e zonave Natura 2000 .....	20
4.2.3	Mbrojtja e vendeve.....	20
4.3	Dialogu mes aktorëve në ujërat Spanjolle .....	22
4.3.1	Të përgjithshme .....	22
4.3.2	Puna me aktorët përgjatë bregdetit jugor të Spanjës .....	22
5	Lumenjtë .....	23
5.1	Të përgjithshme .....	23
5.2	Vendosja e bazës sociale për rehabilitim Lumi Ain, Francë .....	24
5.2.1	Të përgjithshme .....	24
5.2.2	Puna në partneritet.....	24
5.2.3	Ndërgjegjësimi i publikut .....	26
5.2.4	Rivendosja e dinamikës natyrore në lumin Danub .....	26
5.3	Një koncept gjithëpërfshirës për menaxhimin e lumenjve.....	27
5.3.1	Të përgjithshme .....	27
5.3.2	Një koncept gjithëpërfshirës për menaxhimin e lumenjve.....	27
5.3.3	Projekte plotësuese përgjatë Danubit .....	28
6	Kullotat.....	28
6.1	Të përgjithshme .....	28
6.2	Testimi i metodave të përshtatshme të përdorimit të tokës për kullotat dhe shpendët në Spanjë 30	
6.3	Efekti nxitës.....	32
6.4	Përdorimi i ruajtjes së natyrës për të zhvilluar pika të reja shitjeje për produktet bujqësore në Rhön, Gjermani .....	32
6.4.1	Të përgjithshme .....	32
6.4.2	Përfshirja e Fermerëve.....	33
6.4.3	Krijimi i pikave të reja të shitjes së produkteve bujqësore .....	34
7	Praktikat më të mira (shkurt).....	36
7.1	Menaxhimi i konflikteve midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj në NATYRA 200036	



Rrjeti - NATYRA 2000



7.2	Kompanitë e energjisë elektrike punojnë për të ndihmuar në shpëtimin e shpendëve grabitqarë.....	36
7.3	Ndërtimi i rrugëve.....	37





Rrieti - NATYRA 2000



## Praktikat më të mira për krijimin dhe menaxhimin e zonave Natura 2000

### 1.1 Rrjeti Natura 2000

Me mbi 25,000 zona të përfshira në Rrjetin Natura 2000, që mbulojnë pothuajse një të pestën e territorit të BE-së, jo vetëm që kërkesat ekologjike të specieve dhe habitateve ndryshojnë ndjeshëm nga njëra në tjetrën, por opsionet e propozuara të menaxhimit duhet të marrin parasysh gjithashtu edhe çështjet ekonomike, sociale dhe kërkesat kulturore të zonës në fjalë si dhe karakteristikat e tyre rajonale dhe lokale.

Duke marrë parasysh se shumica e zonave Natura 2000 janë në pronësi private dhe përdoren për qëllime të tjera përveç ruajtjes së natyrës, është thelbësore që palët e interesuara të përfshihen në mënyrë aktive në gjetjen e zgjidhjeve praktike për menaxhimin afatgjatë të këtyre zonave.

Qëllimi nuk është ndalimi i aktiviteteve ekonomike në tërësi, por vendosja e parametrave me të cilët ato mund të zhvillohen, duke ruajtur (ose restauruar) speciet dhe habitatet e rralla të pranishme në një status të favorshëm ruajtjeje. Faktikisht, shumë zona Natura 2000 janë të vlefshme pikërisht për shkak të mënyrës se si ato janë menaxhuar deri më tani dhe është e rëndësishme të sigurohet që këto lloj aktiviteteve (p.sh. bujqësia ekstensive) të mund të vazhdojnë në të ardhmen. Kështu, përcaktimi i kërkesave ekologjike të një specieve ose habitati është vetëm një pjesë e ekuacionit - po aq i rëndësishëm është procesi i punës me palët e interesuara për të gjetur mënyra për zbatimin e këtyre dispozitave në mënyrë që të arrihen rezultate të qëndrueshme afatgjatë.

Ka shumë shembuj se si kjo është arritur me sukses në vende të ndryshme të BE-së. Më poshtë paraqitet një pjesë e vogël e shembujve të ndarë sipas pesë fushave<sup>1</sup> të ndryshme për të ilustruar llojin e proceseve të menaxhimit dhe zgjidhjeve që janë përdorur me sukses në një gamë të gjerë kushtesh të ndryshme ekologjike, sociale dhe ekonomike në të gjithë Evropën. Këto kanë për qëllim të japin një panoramë të asaj që mund të nënkuptojë në praktikë menaxhimi i zonave Natura 2000.

## 2 Menaxhimi i Ligatinave

### 2.1 Të përgjithshme

Ligatinat janë ekosisteme komplekse me rëndësi të madhe, jo vetëm sepse janë bërë caq të rralla dhe janë caq të kërcënuara, por sepse kryejnë funksione të rëndësishme mjedisore dhe ekonomike. Ligatinat që funksionojnë natyrshëm reduktojnë përmytjet, përmirësojnë cilësinë e ujit, sekuestrojnë karbon dhe përfaqësojnë një trashëgimi të vyer kulturore dhe natyrore. Për shkak të përbërjes dhe strukturës së tyre komplekse, ato gjenerojnë burime unike bimore e shtazore, peshkim dhe rekrea -

<sup>1</sup> bujqësia, pylltaria, menaxhimi i lumenjve, mjedisi detar dhe ligatinat



Rrjeti - NATYRA 2000



cion. Kombinimi i këtyre funksioneve dhe produkteve i bën këto ekosisteme të paçmueshme për njerëzimin. Pavarësisht nga vlera e tyre e paçmuar, humbja e ligatinave është një fenomen shumë i përhapur. Sot, ligatinat ndikohen nga aktivitetet njerëzore në të gjithë pellgun e tyre ujëmbledhës. Ato janë ndër ekosistemet dhe peizazhet më të kërcënuara në Evropë, kryesisht për shkak të proceseve të kullimit e bonifikimit të tokës, ndotjes dhe mbishfrytëzimit të burimeve ligatinore. Vlerësohet se dy të tretat e ligatinave të Evropës janë zhdukur që nga fillimi i shekullit të 20-të, kryesisht të humbura përmes projekteve zhvillimore të cilat nuk i kanë marrë parasysh siç duhet funksionet dhe vlerat e tyre.

Shumë lloje habitatesh të ligatinave në Evropë tani mbrohen përmes rrjetit Natura 2000. Disa direktiva të tjera gjithashtu kontribuojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në përmirësimin e cilësisë së ligatinave, të tilla si Direktiva për trajtimin e ujërave të zeza urbane (91/271/EEC), Direktiva e Nitrates (91/676/EEC) dhe Direktiva Kuadër e Ujit (20/60) /EC, që është ndoshta instrumenti më gjithëpërfshirës për të përmirësuar cilësinë e të gjithë trupave ujorë.

Ndërkohë që shumë aktivitete për ruajtjen e ligatinave janë fokusuar në rikthimin e habitateve dhe specieve në një gjendje të favorshme ruajtjeje, disa kanë shkuar një hap më tej dhe kanë gjetur mënyra inovatore për të integruar nevojat e ruajtjes me menaxhimin hidrologjik dhe përdorimet e tokës në zonën përreth.

## 2.2 Shembull 1: Një qasje e integruar për menaxhimin e ligatinave Amvrakikos në Greqi

### 2.2.1 Të përgjithshme



Ligatina bregdetare e Amvrakikos, e cila shtrihet në mbi 20,000 ha, është një ekosistem i madh dhe kompleks që formohet nga deltat e dy lumenjve (Louros dhe Arachthos) dhe përfshin kënetën më të madhe në Greqi (Rodia), si dhe disa laguna shumë produktive (Logarou, Tsoukalio, Rodia). Për më tepër, ka mjaft gjire të cekëta, kallamishte, livadhe të lagështa, baltovina, kodra të pyllëzuara dhe tokë bujqësore. Llojet e ndryshme të habitateve strehojnë të paktën 82 lloje shpendësh të Aneksit I të Direktivës së Shpendëve, duke përfshirë *Pelecanus crispus*, *Aythya nyroca*, *Phalacrocorax pygmaeus*, *Botaurus stellaris*, *Aquila clanga* dhe *Aquila pomarina*.

Ashtu si me shumë ligatina të tjera bregdetare në Evropë, zona të konsiderueshme u bonifikuan për bujqësi, të dy lumenjtë u kanalizuan dhe uji i ëmbël nuk derdhej më në ligatina. Hidrologjia natyrore e të gjithë kompleksit ligatinor u ndërpre rëndë, me pasoja të thella si





Rrieti - NATYRA 2000



për kafshët e egra ashtu edhe për aktivitetet bujqësore lokale. Pothuajse menjëherë toka u bë aq e kripur sa nuk mund të përdorej më për bujqësi. Me kalimin e kohës, aktivitete të tjera kontribuan në degradimin e mëtejshëm të ligatinave, si prerja e pyjeve, helmimi i shpendëve për kontrollin e grabitqarëve, mbikullotja, gjuetia e paligjshme dhe ndotja nga fabrikat në periferi të ligatinave.

## 2.2.2 Një qasje e integruar ndaj menaxhimit

Përballë problemeve të tilla komplekse hidrologjike dhe dëmeve të vazhdueshme të shkaktuara nga aktivitetet e paqëndrueshme të përdorimit të tokës, u kuptua se e vetmja mënyrë për të trajtuar këto çështje në një mënyrë koherente në një zonë kaq të madhe dhe të paarrtshme ishte zhvillimi i një strategjie të integruar menaxhimi për të gjithë zonën.



Kjo nuk nënkuptonte vetëm koordinimin e aktiviteteve për restaurimin dhe menaxhimin e habitateve dhe specieve të pranishme, por edhe sigurimin që asetet natyrore të zonës të konsideroheshin plotësisht në planet e zhvillimit rajonal për rajonin e Amvrakikos në tërësi. Me një reputacion ndërkombëtar si një pikë e nxehtë e biodiversitetit, delta është e vendosur në mënyrë ideale për të përfituar nga tregu në zhvillim i eko-turizmit. Kjo nga ana tjetër do të ndihmonte në diversifikimin e aktiviteteve ekonomike lokale larg programeve të pasuksesshme bujqësore të viteve 1980.

Tre organizata<sup>2</sup> u bashkuan për të zhvilluar dhe zbatuar një

projekt që synonte:

- Restaurimin e lagunave dhe veçorive të tyre hidrologjike,
- Ruajtjen dhe menaxhimin e habitateve dhe gjashtë llojeve prioritare të shpendëve duke përfshirë pelikanin kaçurrel (për të cilin zona është një nga më të rëndësishmet në Evropë)
- Zovogëlimin e humbjeve të breshkave të detit në gjiret përreth duke bashkëpunuar ngushtë me peshkatarët vendas.

Së pari ishte e nevojshme të zhvillohej një bazë e fortë informacioni mbi burimet natyrore të zonës dhe statusin e tyre të ruajtjes. Përpara projektit, pak masa restauruese ishin realizuar në zonë, kështu që puna duhej të fillonte pak a shumë "nga e para". Për këtë qëllim, u realizuan një sërë inventarësh të detajuar dhe u hartuan plane për secilën nga speciet dhe habitatet kryesore. Gjashtë speciet prioritare të shpendëve u monitoruan në mënyrë sistematike, u krijua një bazë të dhënash dhe u përcaktuan prioritetet e ruajtjes. Rezultatet e marra kontribuan në përcaktimin e nevojave të

<sup>2</sup> Agjensia lokale e Zhvillimit për Gjirin e Amvrakikos S.A (ETANAM), një kompani private konsultuese me një histori të gjatë në ruajtjen e moçalishteve në Greqi dhe një OJQ (Archelon).





Rrjeti - NATYRA 2000



menaxhimit të habitateve në Amvrakikos. U bë një identifikim dhe hartëzim i detajuar i llojeve të habitateve, veçanërisht atyre habitateve që kanë rëndësi për avifaunën. Përveç kësaj, makrofitet e lagunave Rodia, Tsoukalio dhe Logarou u kampionuan dhe u vlerësuan për të përshkruar më mirë habitatet e lagunës dhe për të identifikuar parametrat abiotikë dhe biotikë.

Në fund të fazës së mbledhjes së informacionit, projekti kishte rritur ndjeshëm njohuritë për avifaunën, lagunat dhe çështjet e lidhura me ujën në zonë. Informacioni u përdor për të krijuar një sërë mjeteve shumë të dobishme të menaxhimit dhe monitorimit (plani i menaxhimit të ujit, udhëzuesi i menaxhimit të kallamishteve, sistemi i monitorimit të ujit, plani i monitorimit të habitateve, etj.) të cilat mund të zbatoheshin si brenda kohës së projektit ashtu edhe në një afat më të gjatë.

Përbërësi tjetër kyç për zbatimin e suksesshëm të projektit ishte i lidhur me nevojën për të fituar mbështetje lokale dhe pranim për aktivitetet e ndryshme. Projekti bëri shumë përpjekje për të përfshirë grupet e interesuara në procesin e vendimmarrjes dhe organizimin e eventeve të ndryshme për t'i lejuar njerëzit të zbulojnë trashëgiminë e tyre natyrore lokale. Kjo u mbështet më tej nga puna e gjerë në media dhe prania e përhershme e stafit të projektit (të gjithë ishin nga rajoni).

Falë këtyre veprimeve përgatitore, vetë punimet aktuale të restaurimit vazhduan pa probleme, pa pengesa teknike dhe me mbështetjen e plotë të komuniteteve lokale, të cilët panë në këtë projekt një rrugë të re për rigjallërimin e ekonomisë lokale.



### 2.2.3 Vlera demonstruese

Një planifikim i tillë i kujdesshëm bëhet edhe më i rëndësishëm po të kemi pasur parasysh natyrën inovative të teknikave të përdorura, veçanërisht për restaurimin e hidrologjisë së ligatinave, e cila pati një ndikim të madh në peisazh. Por rezultatet folën vetë. Lagunat u përgjigjën menjëherë pasi u rilidhën me burimin e tyre të ujërave të ëmbla nga lumi Louros. Nja dy muaj pas përfundimit të punimeve, struktura e bimësisë evoluoi, gropat gëlqerore filluan të rimëkëmbeshin dhe niveli i kripësisë në dy lagunat u ul ndjeshëm. Nga kjo nuk përfituan vetëm kafshët e egra, por edhe komuniteti i peshkimit, i cili mbështetej tek lagunat prodhuese për kapjen e ngjalave dhe peshqve të tjerë.

Një masë tjetër me vlerë të lartë demonstruese ishte krijimi i ishujve artificialë për Pelikanët. Kjo ishte hera e parë që teknika të tilla u testuan në Greqi. Popullata lokale u rrit nga 32 çifte në 92 çifte brenda 3 viteve (2000 – 2003).

Përvoja e fituar në të dyja nismat tërhoqi vëmendjen e shumë mbrojtësve të tjerë të ligatinave në Greqi, të cilët kërkuan të mësonin nga teknikat e zhvilluara në Amvrakikos për t'i përshtatur ato me situatat e tyre.



Rrieti - NATYRA 2000



#### 2.2.4 Efekti nxitës

Projekti LIFE ishte përpjekja e parë e strukturuar për ruajtjen dhe menaxhimin e mjedisit natyror të zonës. Që atëherë, janë nisur disa iniciativa të reja. Ndryshe nga programet e kaluara të zhvillimit, tani të gjithë marrin parasysh vlerat natyrore të ligatinave Amvrakikos. 1.3 milionë euro erdhën nga programi Leader i BE-së për të inkurajuar aktivitetet bujqësore vendase, për të promovuar agroturizmin dhe bizneset e vogla turistike dhe zhvillimin e produkteve vendore që rrjedhin nga zona.

Programi Operacional për Mjedisin (fondet strukturore të BE-së) ka qenë gjithashtu një burim i mirë financimi për disa aktivitete që lidhen me mjedisin natyror (përfshirë realizimin e një studimi mjedisor specifik dhe krijimin e dy qendrave të informacionit), duke sjellë 1.2 milionë euro të tjera në zonën e Amvrakikos. Projekte të tjera kanë parë gjithashtu dritën e zbatimit, duke përfshirë për shembull projektin e eko-turizmit të Manastirit të Profetit Ilias, financuar nga programi i peshkimit të BE-së (PESCA).

Për sa i përket menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit natyror, aktivitetet e propozuara ofrojnë një mbështetje themelore për krijimin e një organizmi drejtues, përpunimin e planit të tij 5-vjeçar të menaxhimit, punime të ndryshme që lidhen me ndërgjegjësimin e publikut, zgjerimin e sistemit telemetrik për monitorimin e ujit, monitorimin e ekosistemit, blerjen e tokës, ndërhyrjet/restaurimet teknike dhe krijimin e një “qendre rehabilitimi” për kafshët e egra.

Në përgjithësi, duke u nisur nga një mjedis i degraduar dhe një bazë e dobët ekonomike, projekti LIFE-Nature shënon një pikë kthese të jashtëzakonshme për zonën falë qasjes së integruar në menaxhimin e tij dhe mbështetjes për zhvillimin e qëndrueshëm.

### 2.3 Rehabilitimi i ligatinave në stepat Hortobagy, Hungari

#### 2.3.1 Të përgjithshme

Parku Kombëtar Hortobagy në Hungarinë lindore është në mes të “puszta”, një zonë unike e stepës, karakteristike për këtë pjesë të globit. Ai është gjithashtu një pikë e rëndësishme për vëzhguesit e shpendëve nga e gjithë Evropa. Me rëndësi themelore për vlerën e tij ornitologjike janë hapësirat e mëdha të stepave dhe kënetave të kripura Panonike. Këto janë formuar gjatë dhjetë mijë viteve të fundit përmes kombinimit unik të një klime kontinentale, relievit të sheshtë dhe përmytjeve pranverore nga lumi Tisza aty pranë.





Rrjeti - NATYRA 2000



Në pranverë, uji nga lumi përhapet në një zonë të madhe, por është vetëm disa centimetra i thellë për shkak të rrafshësisë së zonës. Këto ligatina të mëdha të cekëta janë perfekte për qindra mijëra shpendë shtegtarë. Në verë uji tërhiqet derisa pothuajse të gjithë liqenet e cekët thahen, duke lënë një mozaik me kullota alkaline, të thata ose të lagështa, në të cilat mund të lulëzojnë bimë të pazakonta halofite (që duan kripën), të ngjashme me speciet që zakonisht gjenden në bregdet. Për shekuj me radhë, kullotja tradicionale me tufa të mëdha bagëtish ka kontribuar në ruajtjen e një strukture të hapur vegjetative.



Në shekullin e 20-të, veçanërisht gjatë epokës socialiste, këtij ekosistemi të çmuar iu dhanë disa goditje të forta. Kullotja pothuajse u braktis, ose u zëvendësua nga forma shumë intensive të blegtorisë si rritja e patave (mijëra zogj të grumbulluar në fusha). Një rrjet i gjerë digash dhe kanalesh vaditëse u shtri mbi mijëra hektarë, me qëllim që të krijoheshin fusha të pafundme orizi dhe sisteme për vaditjen e kullotave. Ky eksperiment përfundimisht dështoi, dhe në vitet 1990 punimet hidroteknike shëmtonin peizazhin e zonës dhe ndërhyenin në hidrologjinë natyrore të saj. Rrjedhimisht, mozaiku i stepës/kënetës tani ishte ndërprerë në masë të madhe dhe popullatat e zogjve

të stepës ishin shumë më të vogla.

Në vitin 2002, u miratuan për financim dy projekte, të cilat synonin të rikthenin një pjesë të dinamikës natyrore të stepave në Hortobagy, duke u fokusuar, njëri në restaurimin e peizazhit të dëmtuar dhe tjetri në sigurimin e menaxhimit të vazhdueshëm të stepave duke rifilluar kullotjen tradicionale. Edhe pse problemet me të cilat përballet zona janë njohur prej kohësh, kjo ishte hera e parë që një injeksion i konsiderueshëm parash u vu në dispozicion për të ndërmarrë punime të mëdha restauruese.

### 2.3.2 Punimet e Restaurimit

Projekti i restaurimit të peizazhit u drejtua nga Drejtoria e Parkut Kombëtar Hortobagy, autoriteti përgjegjës për parkun kombëtar. Bashkëfinancimi LIFE u përdor për të hequr infrastrukturën e ujitjes dhe për të rivendosur kompleksin e habitateve prioritare të Shtojcës I "Stepat dhe kënetat e kripura Panonike" në një sipërfaqe totale prej gati 10,000 hektarësh. Kjo nënkuptonte prishjen e 500 km argjinatura artificiale dhe kanale vaditëse si dhe prishjen e 300 strukturave prej betoni që nuk përdoren më. Punimet e nevojshme përfshinin zhvendosjen e më shumë se 300.000 m<sup>3</sup> dhe.





Rrieti - NATYRA 2000



Rezultatet u shfaqën mjaft shpejt. Në vitin 2004, u panë një numër i madh i shpendëve ujorë që pushonin në kënetat e restauruara të gërshetuara me habitatet e stepës. Deri në vitin 2005, u vu re rikolonizimi i suksesshëm, nga speciet indigjene të bimëve kripëdashëse, i brezave të gjatë të tokës së zhveshur ku dikur shtriheshin kanalet.

Me habitatet drejt rimëkëmbjes, pyetja ishte: si të sigurohet menaxhimi afatgjatë i tyre për të marrë rezultate optimale, përsa i përket strukturës së vegjetacionit? Deri në fund të projektit, Drejtoria e Parkut Kombëtar menaxhoi një skemë pilot për financimin agro-mjedisor për të mbështetur kullotjen tradicionale në park dhe zonën e tij buferike. Kjo ishte skema e parë agro-mjedisore në shkallë të gjerë në Hungari dhe për këtë arsye edhe me vlerë të lartë demonstruese.

### 2.3.3 Rifillimi i mbikullotjes tradicionale

Krijimi i një sistemi për menaxhimin e kullotave ishte objektivi kryesor i projektit të dytë LIFE të drejtuar nga një OJQ, Shoqata Mjedisore Hortobagy, në partneritet me OJQ të tjera, Drejtorinë e Parkut Kombëtar dhe një ndërmarrje bujqësore lokale.

Projekti hartoi një skemë pilot për të testuar menaxhimin e kullotjes nga bagëtia – si në aspektin ekologjik ashtu edhe në aspektin e qëndrueshmërisë financiare për fermerët. Në këtë pjesë të



projektit, Shoqata Mjedisore Hortobagy punoi ngushtë me një ndërmarrje bujqësore lokale. Duke përdorur fondet e LIFE-it, ajo bleu bagëti të racave tradicionale që kullosnin në “puszta” në të kaluarën, si lopë hungareze gri (137 krerë), derra “Mangalica” (275) dhe dele “Racka” (150). LIFE financoi gjithashtu edhe ndërtimin e stallave.

Faktikisht, në të kaluarën, blegtoria në puszta bazohej në mbikullotjen, e cila në mënyrë paradoksale ishte e dobishme ekologjikisht sepse krijonte habitatet me bar të shkurtër dhe të zhveshura që ishin të nevojshme për lloje të caktuara shpendësh që folezojnë në tokë. Projekti synonte të rikrijonte qëllimisht këtë istem menaxhimi

përmes mbikullotjes.

Kështu, kullotja shumë intensive nga lopët do ta mbante barin të shkurtër dhe do t'i jepte shoqërimeve bimore halofitike, si *Puccinellio-Salicornetea*, të cilat nuk mund të konkurrojnë me barëra më të fuqishme, hapësirë për të mbirë dhe përhapur në toka të përshtatshme alkaline. Ndërsa gërmimet e derrave “Mangalica” do të krijonin njolla të hapura në tokë, të cilat mund të përdoreshin nga shpendët e ujit për t'u ushqyer dhe, në kohët kur nuk mbusheshin me ujë, për folezim nga shpendët që folezojnë tokë. Fondet e LIFE u përdorën gjithashtu për dhënie me qira të tokës për të kultivuar foragjere dimërore, në mënyrë që kafshët të mund të mbaheshin gjatë gjithë vitit dhe kështu të ruanin presionin e lartë të kullotjes, jetike për të krijuar strukturën e duhur të vegjetacionit për avifaunën dhe bimët e rralla.





Rrieti - NATYRA 2000



### 2.3.4 Monitorimi dhe qëndrueshmeria ekonomike

Ky përdorim i mbikullotjes së stepës për të siguruar ruajtjen e habitateve natyrore nuk ishte testuar më parë në Hungari. Prandaj, projekti caktoi një sërë parcelash monitoruese me zona të pakullotura, me kullotje të lehtë, me kullotje intensive, të përmytura dhe jo të përmytura. Qëllimi ishte gjetja e marrëdhënies optimale midis kullotjes dhe shumëllojshmërisë së specieve. Këto të dhëna monitorimi, të cilat do të vazhdojnë të mblidhen shumë kohë pas përfundimit të projektit, do të jenë të dobishme si për menaxhimin e kullotave ashtu edhe për zhvillimin e skemave të përshtatshme agro-mjedisore.

Për shkak se menaxhimi i bagëtive është një punë për fermerët, një pjesë po aq jetike e ndjekjes së projektit është vlerësimi nëse një kullotje e tillë me përfitime ekologjike është e zbatueshme në aspektin ekonomik. Për ta bërë këtë, partneriteti midis shoqatës dhe një ndërmarrje bujqësore lokale filloi një nga projektet e para të eko-bujqësisë në Hungari, bazuar në bagëtitë në zonën e projektit. Objektivi ishte që sistemi i kullotjes të ishte i vetë-qëndrueshëm financiarisht deri në fund të projektit në 2006.

Për shkak se bagëtitë që kullosin stepat dhe kënetat e zonës Panonike janë brenda termave të referencës për bujqësinë organike, ka interes tregtar për mishin dhe produktet e tjera. Jo vetëm në nivel lokal – përmes një dyqani fermash dhe përmes dërgesave për shitësit me shumicë në rajonin më të gjerë – por edhe nga Gjermania, ku një prodhues i ushqimeve për fëmijë po shikon përdorimin e mishit nga bagëtitë tradicionale dhe derrat e rritur në një mjedis të pastër dhe të gjelbër.

Dy vende pune me kohë të plotë u krijuan gjatë projektit LIFE për mbikëqyrjen e bagëtive – përveç 562 kafshëve të blera përmes LIFE, të tjerat ishin blerë përmes kanaleve të tjera, kështu që deri në vitin 2005 zona e projektit po kullotej nga 1456 njësi blegtorale. Turizmi i fermave është gjithashtu premtues, me vizitorët që vijnë për të parë jo vetëm peizazhin e "puszta", por edhe bagëtitë e veçanta që kullosin në të. Projekti LIFE ndihmoi në mbështetjen e këtij trendi duke ngritur disa shtigje dhe pika vëzhgimi.



## 3 Pyjet

### 3.1 Të përgjithshme

Sot, rreth një e treta e territorit evropian është e mbuluar nga pyjet, megjithatë shtrirja ndryshon ndryshëm midis shteteve (deri në 72% në Finlandë dhe deri në 8% në Irlandë). Shumica e pyjeve përkufizohen si "të përdorshëm për furnizim me lëndë drusore" dhe i nënshtrohen shkallëve të ndryshme të intensitetit të përdorimit njerëzor. Që nga anëtarësimi i Austrisë, Finlandës dhe Suedisë,



Rrieti - NATYRA 2000



BE-ja është bërë prodhuesi i dytë më i madh në botë i letrës dhe lëndës së sharruar, duke punësuar rreth 2.2 milionë njerëz dhe duke gjeneruar mbi 300 milionë euro në vit.

Përveç kësaj, pyjet kryejnë një sërë funksionesh të tjera të rëndësishme, duke filluar nga parandalimi i erozionit, mbajtja e ujit dhe sekuestrimi i karbonit deri te përdorimi për qëllime rekreative, të cilat, në shumë aspekte, konsiderohen po aq të rëndësishme sa prodhimi i lëndës druspre dhe celulozës.

Si rezultat i programeve të pyllëzimit dhe rigjenerimit natyror, sipërfaqja e mbuluar me pyje në BE po rritet. Megjithatë pjesa më e madhe janë pyje për qëllime komerciale me lloje ekzotike, të cilat janë me interes të ulët ekologjik. Efektet e kombinuara të praktikave gjithnjë e më intensive silvikulturore, rritjes së uniformitetit dhe përdorimit të llojeve ekzotike ka çuar në një rënie të cilësisë mjedisore të ekosistemeve pyjore.

Shumë pak, ndoshta më pak se 1-3%, e pyjeve janë vërtet të virgjër e natyrorë. Shumica e pyjeve gjysmë natyrore fillimisht strehonin një bimësi unike dhe një gamë të gjerë llojesh pyjore. Megjithatë, pyjet gjysmë-natyrore janë duke degraduar pasi teknikat tradicionale të mbarështrimit, si prerja selektive, ri-cungimi, krasitja dhe kullotja e pyjeve, po bëhen gjithnjë e më joekonomike përballë pylltarisë moderne. Kjo ka lënë vetëm pjesë të vogla të izoluara të pyjeve natyrore ose gjysmë-natyrore në zona rurale, shpesh të largëta dhe pak të aksesueshme.

Kjo praktikë ka çuar gjithashtu në një rënie dramatike të numrit shumë llojeve të varura nga pyjet. Për shkak të kompleksitetit të tyre strukturor, pyjet ofrojnë habitate ideale për një grup veçanërisht të pasur bimësh dhe kafshësh dhe një strehë natyrore për shumë mishngrënës të mëdhenj, si arinjtë dhe ujçërit, të cilët dikur ishin një tipar karakteristik i peizazheve pyjore të Evropës.

Situata përkeqësohet më tej nga fragmentimi i madh i burimeve pyjore të mbetura dhe humbja e habitateve të lidhura me to si kullotat, brezat pyjorë, pyjet buzë lumenjve, etj., të cilat luajnë një rol thelbësor si “korridoreve ekologjike”.

Në Aneksin I të Direktivës së Habitaveve janë të listuara mbi 70 lloje të ndryshme habitatesh pyjore, një pjesë e mirë e të cilave janë klasifikuar si prioritare. Në total, ato korrespondojnë me një të tretën e të gjithë habitateve të mbuluara nga Direktiva. Megjithatë, numri i madh i llojeve të habitateve në Aneksin I nuk nënkupton një burim të bollshëm. Përkundrazi, konfirmon natyrën e tyre përgjithësisht të rrallë dhe të izoluar. Mbi 50% e këtyre habitateve janë të kufizuara në vetëm një ose dy vende (dhe në disa raste në vetëm një ose dy zona Natura 2000). Shembujt tipikë përfshijnë: kullotat e pyllëzuara “Fennoskandian” që gjenden vetëm në Finlandë dhe Suedi, pyjet endemike të pishave Kanariane apo pyjet e bredhit Nebrodi të Sicilisë. Vetëm një pjesë e vogël e habitateve pyjore “më të zakonshme” dhe më të njohura si pyjet aluviale, pyjet e dushkut apo një larmi e pyjeve të ahut shtrihen në shumë shtete.

Për të ndihmuar në përzgjedhjen e zonave për Natura 2000 për mbrojtjen e habitateve pyjore, Shtetet Anëtare dhe Komisioni Evropian kanë rënë dakord që ato duhet të fokusohen veçanërisht në:

- pyjet e llojeve vendase,
- pyjet me një shkallë të lartë natyraliteti,





Rrjeti - NATYRA 2000



- pyjet me drurë të lartë,
- praninë e drurëve të vjetër dhe të kalbur,
- pyjet me një sipërfaqe të konsiderueshme, dhe
- pyjet që kanë përfituar nga menaxhimi i qëndrueshëm gjatë një periudhë afatgjatë.

Këto parime tregojnë se përparësi duhet t'u jepet pyjeve autoktone me pak ndërhyrje njerëzore dhe/ose atyre që tashmë i nënshtrohen praktikave të menaxhimit të qëndrueshëm që favorizojnë biodiversitetin. Vlerësohet se dy të tretat e zonave të përfshira në rrjetin Natura 2000 kanë të paktën një lloj habitati pyjor, gjë që sugjeron se ato priren të jenë pjesë e një matrice komplekse habitatesh brenda një zone më të madhe.

Gama e masave të ndërmarra për ruajtjen e pyjeve është pothuajse aq e larmishme sa vetë llojet e habitateve. Shumë prej tyre përfshijnë masa fillestare të njëhershme restauruese në mënyrë që të rikthehet pylli në gjendjen e tij origjinale të ruajtjes. Shumica e masave mbështesin hartimin e planeve të menaxhimit në bashkëpunim të ngushtë me aktorët lokalë dhe autoritetet pyjore. Disa të tjera përpiqen të nxisin mënyra novatore për të bashkuar ruajtjen e natyrës me aktivitetet ekonomike. Ka edhe masa që fokusohen në çështjet e menaxhimit të kafshëve të egra, për shembull, krijimi i habitateve dhe korridoreve të përshtatshme për lloje të lidhura ngushtë me pyllin si ariu apo gjeli i egër.

## 3.2 Ruajtja e llojeve pyjore të rrezikuara në Apennine, Itali

### 3.2.1 Të përgjithshme

Bredhi i bardhë (*Abies alba*), Hormoqi (*Picea excelsa*) dhe Tisi (*Taxus baccata*) hasen rrallë në të gjithë zinxhirin malor të Apennineve dhe mbijetojnë vetëm në popullata relikte të reduktuara dhe të fragmentuara. Këto popullata relikte jo vetëm që përbëjnë raca gjenetiki të ndryshme në Apennine, por ndryshojnë edhe nga ato që gjenden në Alpe.

Popullatat e këtyre llojeve drusore në Emilia Romagna, ku u zhvilluan dy projekte të mbështetura nga LIFE-Nature, përbëhen nga individë shumë të moshuar me mundësi të kufizuara rigjenerimi natyror. Praktikata e silvikulturës që nga fillimi i shekullit të 20-të, të cilat favorizonin drurët lastarizues, si dhe pyllëzimet me ah (*Fagus sylvatica*), dhe shtimi i kullotjes në pyje, përkeqësuan më tej statusin e këtyre llojeve.



Rrieti - NATYRA 2000



### 3.2.2 Rëndësia e projekteve LIFE



Monitorimi dhe ndërhyrjet e vogla, të financuara nga Rajoni Emilia-Romagna përpara fillimit të projekteve LIFE-Nature, zbuluan një nevojë urgjente për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të këtyre popullatave relikte. Dy projektet LIFE-Nature hodhën bazën për mbrojtjen e llojeve dhe për menaxhimin e qëndrueshëm të masiveve pyjore të Apenineve; sidomos në zonat ku hasen këto lloje të rrezikuara.

- Projekti i parë, në vitin 1995, rriti njohuritë për këto lloje habitatesh relikte dhe testoi masat e para të ruajtjes;
- Projekti i dytë i vitit 1997 përmirësoi dhe zbatoi më tej këto masa dhe stimuloi një shpërndarje më të gjerë të përvojës së fituar.

Për të marrë një pamje të saktë të shpërndarjes së llojeve të drurëve objekti i projektit u realizua inventarizimi i pyjeve ku ato hasen, duke identifikuar të gjithë grumbujt e duke regjistruar të dhëna për strukturën dhe përbërjen e llojeve. Të gjitha të dhënat u hartëzuan duke

përdorur GPS. Aty ku nevojitej, u regjistruan dhe hartëzuan edhe drurë të vetëm duke shënuar edhe bimësinë përreth.

Ky studim lejoi formulimin e një metodologjie menaxhimi për mbrojtjen e pyjeve të bredhit dhe hormoqit të Apenineve, duke siguruar praninë e çeltirave dhe mbrojtjen nga kullotja. Në fakt, inventari tregoi qartë se shqetësimi dhe konkurrenca ishin me të vërtetë faktorë negativë shumë domethënës. Të gjitha popullatat e ekzaminuara treguan ndryshime serioze për shkak të shfrytëzimit të pyjeve dhe kullotjes në të kaluarën.

Gjithashtu, u analizua përshtatshëria e farave të llojeve të synuara. Për këtë, u mbledhën farat e të tre llojeve dhe u mbajtën në një fidanishte të posaçme nën kujdesin e Parkut Rajonal "Boschi di Carrega". Farat u mbollën me kujdes, duke shënuar saktë origjinën e aterialit mbjellës.

Ishte e nevojshme të mblidheshin sa më shumë fara, pasi përshtatshëria e tyre rezultoi shumë e ulët, ndoshta për shkak të kushteve ekstreme në të cilat gjenden drurët farorë. Ky shpjegim mbështetet nga përshtatshëria shumë më e lartë e farave nga zona e Lago Verde, ku kushtet mjedisore janë dukshëm më të përshtatshme. Megjithatë, pavarësisht problemeve të përshtatshërisë së ulët, në fund u arritën rezultate të mira pasi fidanishtja ishte në gjendje të prodhonte një numër të mjaftueshëm fidanësh të bredhit të bardhë dhe hormoqit. Gjithashtu, u përdorën edhe metoda të mikroshumëzimit për të garantuar riprodhimin, veçanërisht për tisin.

### 3.2.3 Ridrejtimi i menaxhimit të pyjeve

Për të parandaluar dëmtimet e fidanëve të bredhit nga kullotja u vendosën gardhe, të cilët kontrolloheshin rregullisht për dëmtime dhe lëvizje të paligjshme të bagëtive. Në këtë vëzhgim morën pjesë edhe pronarë privatë. Pranë Monte La Nuda, popullatat lokale të bredhit u mbrojtën edhe nga





Rrieti - NATYRA 2000



erozioni i vazhdueshëm nëpërmjet punimeve inxhinierike përforcuese. Erozioni shkaktohej si pasojë e punimeve të mëparshme për ndërtimin e një resorti skish aty pranë dhe, në disa seksione, ndikonte direkt në grumbujt e bredhit.

Cungimi ishte shkaku i drejtpërdrejtë i fragmentimit dhe zhdukjes së pyjeve të ahut përzier me bredh e tis në Apenine . Prandaj, shndërrimi i cungishteve në pyje trungishte të përziera e shumëmoshore është një “investim strategjik” i rëndësishëm i ndërmarrë nga këto projekte. Masa të tilla për menaxhimin e pyjeve u kryen pranë grumbujve autoktone të halorëve. Puna pioniere e këtyre projekteve është përforcuar më shumë nga një ligj italian (Përshkrimet e përgjithshme të politikës pyjore), i cili ndalon rikthimin në cungishte të pyjeve trungishte që kanë përfituar nga financimet publike.



### 3.2.4 Trajnime dhe ndërgjegjesim



Ndërhyrjet silikulturore të kryera nga këto projekte ishin novatore dhe mjaft të ndryshme nga ato të përdorura në pyjet prodhuese. Punëtorët e shfrytëzimit të pyjeve nuk ishin mësuar me këto teknika të reja të menaxhimit dhe në fillim ata duhej të mbaheshin nën mbikëqyrje të vazhdueshme gjatë punës së tyre nga një teknik pyjor (në të kaluarën, ka ndodhur më shumë se një herë që punëtorët e pambikëqyrur të krasitin dhe madje të prisnin drurë të vjetër të bredhit).

Megjithatë, rezultati ishte i suksesshëm pasi punëtorët, të ndihmuar nga trajnimi i duhur i dhënë nga autoritetet e ruajtjes së natyrës, mësuan përfundimisht se si t'i zbatonin këto teknika të reja në mënyrë efikase. Ky është një investim i rëndësishëm për të ardhmen, pasi Rajoni Emilia Romagna synon të zbatojë këtë lloj menaxhimi në shumicën e pyjeve në

territorin e tij.

Projekti u shoqërua me disa aktivitete komunikimi e ndërgjegjesimi: artikuj në gazetatat lokale, video, transmetime nga TV lokale dhe faqet e internetit, seminare shkencore, kalimi i shtigjeve për ecje në fidanishten Vezzosa ose në popullatat relikte (Lago Verde). Studimet e kryera gjatë projekteve LIFE-Nature po përdoren tani në përpunimin e planeve të menaxhimit të pyjeve të shumë zonave pyjore në Rajonin Emilia Romagna.



Rrieti - NATYRA 2000



### 3.3 Restaurimi i pyjeve fletorë në Parkun Kombëtar Söderåsen, Suedi

#### 3.3.1 Të përgjithshme



Pyjet fletorë, të pasura me lloje, të dominuara nga lisi, ahu, frashri dhe vidhi, janë faza përfundimtare e suksesionit natyror për masivet pyjore në shumë zona të Evropës Qendrore dhe Perëndimore. Për shekuj, pjesa më e madhe e tyre është shndërruar në toka bujqësore dhe së fundmi, me zhvillimin e industrisë moderne pyjore, shumica e pyjeve natyrore të mbetura janë prekur rëndë nga praktikatat e shfrytëzimit apo dhe janë zëvendësuar me plantacione. Këto të

fundit shpesh përfshijnë zëvendësimin e drurëve fletorë me lloje halore. Për më tepër, drurët me prejardhje nga zona të ndryshme gjeografike janë zhvendosur në vende të reja dhe janë futur lloje të huaja drurësh. Efekti i përgjithshëm është një ndikim negativ dhe humbje e biodiversitetit në shumicën e zonave të pyjore të Evropës.

Parku Kombëtar Söderåsen, i vendosur në qarkun Skåne në pjesën më jugore të Suedisë, strehon një nga zonat më të mëdha të pyjeve fletore, të pasura me lloje, në Evropën Veriore. Megjithëse pjesa më e madhe e pyllit është prekur nga aktivitetet e menaxhimit në të kaluarën, menaxherët e parkut e konsideruan të mundur fillimin e një projekti restaurimi në shkallë të gjerë menjëherë pasi u krijua parku kombëtar në 2001.



Forca kryesore lëvizëse ishte fakti se një strategji afatgjatë për ruajtjen e pyjeve fletorë nuk duhet të përqendrohet vetëm në mbrojtjen e fragmenteve të mbetura, por duhet të gjejë gjithashtu mënyra për të hequr plantacionet halore dhe për të nisur një proces të rigjenerimit të pyjeve fletorë. Administrata e parkut kishte kontroll të plotë të përdorimit të tokës pasi parku kombëtar është në pronësi publike, dhe kjo bëri të mundur testimin e metodave të ndryshme të menaxhimit, në mënyrë që të fitoheshin përvoja të rëndësishme për punën e ardhshme me pyjet fletorë.

#### 3.3.2 Testimi dhe zbatimi i metodave inovative

I nisur në vitin 2002, projekti testoi metoda të ndryshme restaurimi për të ndaluar degradimin e habitateve pyjore. Aktivitete të ndryshme, si heqja e plantacioneve të bredhit apo filizërisë së bredhit në nënpyllin e grumbujve fletorë, dhe skarifikimi (gërvishtja) e tokës janë ndërmarrë për të përmirësuar kushtet për rigjenerimin e fletorëve, si edhe mbjellja apo përgatija e lendeve të dushkut apo farave të ahut për mbjellje.





Rrieti - NATYRA 2000



Deri në fund të projektit synohej që tendenca e degradimit të jetë përmbysur drejt një statusi më të favorshëm ruajtjeje për 1070 hektarë pyje, ose rreth dy të tretat e sipërfaqes totale të parkut kombëtar. Habitatet kryesore që përfitojnë janë pyjet e ahut, por edhe pyjet aluviale etj., megjithëse rezultatet përfundimtare të pritura në drejtim të një statusi të përmirësuar të ruajtjes janë një objektiv afatgjatë që mund të arrihet jo më herë se 20-30 vjet.

Sfidë e veçantë ka qenë shmangia e dëmtimeve në terren gjatë punimeve të restaurimit dhe për këtë qëllim janë testuar metoda të ndryshme miqësore me mjedisin si alternativa ndaj makinerive që përdoren kryesisht në punimet pyjore. Kjo ka përfshirë përdorimin e kuajve në vend të traktorëve dhe makinerive të tjera, si dhe angazhimin e një race lokale të derrave "Linderöd" për gërvishtjen e tokës. Kjo lidhet edhe me traditën historike lokale, ende në përdorim në vitet 1930, për të mbajtur derrat që kullosin tokat e pasura me lëndë ushqyese.

Metodat e restaurimit rezultuan të ishin të dobishme në përmirësimin e statusit të e ruajtjes së llojeve të ndryshme që vuajnë nga degradimi i pyjeve fletorë natyrorë. Këtu përfshihen rreth 63 insekte të rralla, 22 briofite dhe 36 kërpudha, si dhe mjaft shpendë folezues si Qifti i Kuq (*Milvus milvus*), Mizakapësi gushëkuq (*Ficedula parva*) dhe Qukapiku i Zi (*Dryocopus martius*).



Projekti tërhoqi shumë vëmendje në lidhje me vlerën e tij demonstruese dhe nxitjen e nismave të tjera të ngjashme. Zona është bërë pjesë e vizitave studimore nga shkencëtarë, studentë, menaxherë dhe administratorë të zonave të mbrojtura nga pjesë të ndryshme të Suedisë si dhe nga disa vende të tjera evropiane, duke përfshirë Danimarkën, Gjermaninë, Poloninë, Estoninë dhe Lituanië.

Parku kombëtar tërheq gjithashtu shumë interes nga publiku i gjerë. Me 100,000-200,000 vizitorë në vit, ai ka një potencial të madh për të promovuar konceptin e Natura 2000 dhe multifunksionalitetin e pyjeve.

## 4 Mjedisi detar

### 4.1 Të përgjithshme

Detet që rrethojnë Bashkimin Evropian janë ndër më të pasurit dhe më produktivët në botë. Ata janë gjithashtu ndër më të kërcënuarit. Kërcënimet përfshijnë humbjen dhe degradimin e biodiversitetit



Rrieti - NATYRA 2000



dhe ndryshimet në strukturën e tij, humbjen e habitateve, ndotjen nga substancat dhe lëndët ushqyese të rrezikshme dhe efektet e mundshme të ndryshimeve klimatike.

Presionet që shkaktojnë këto kërcënime përfshijnë: peshkimin, shfrytëzimin e naftës dhe gazit, transportin detar, eutrofikimin, hedhjen e mbetjeve, turizmin dhe nxjerrjen e rërës dhe mineraleve të tjera, të cilat përkeqësohen më tej nga qasja shumë sektoriale ndaj menaxhimit dhe përgjegjësitë komplekse ligjore.

Komisioni Evropian ka propozuar një strategji ambicioze për të mbrojtur mjedisin detar në të gjithë Evropën. Strategjia Tematike për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Detar synon të arrijë statusin e mirë mjedisor të ujërave detare të BE-së deri në vitin 2021 dhe të mbrojë bazën e burimeve nga e cila varen aktivitetet ekonomike dhe sociale të lidhura me detin.

Anekset e direktivave të Habitave dhe Shpendëve listojnë 9 lloje habitatesh, 29 shpendë dhe 18 kafshë të tjera detare që kanë nevojë për mbrojtje për shkak të statusit të pasigurt të ruajtjes. Këtu përfshihen specie të tilla të njohura si foka mesdhetare, breshka e detit, delfini hundë shishe, si dhe habitate të rralla si shkëmbinj nënujorë të ujërave të ftohta apo livadhet me posidonia.

Zbatimi i Direktivave të Habitave dhe Shpendëve në mjedisin detar paraqet disa sfida thelbësore, veçanërisht për sa i përket ujërave larg bregut, për shkak të vështirësive në grumbullimin e të dhënave shkencore mbi shpërndarjen dhe sasinë e llojeve dhe habitateve. Kështu, ndërsa përcaktimi i zonave Natura 2000 në ujërat bregdetare dhe në breg konsiderohet të jetë mjaft i avancuar, ka ende boshllëqe të rëndësishme në rrjetin Natura 2000 për sa i përket mjedisit detar në det të hapur.

Shumë aktivitete ruajtjeje fokusohen para së gjithash në ndërtimin e një baze të shëndoshë njohurish mbi speciet dhe habitatet detare, në mënyrë që të mundësohet identifikimi dhe hartimi i masave të duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre, dhe për të siguruar një përdorim të qëndrueshëm të burimeve detare. Po aq i rëndësishëm është edhe bashkëpunimi dhe dialogu i ngushtë me një gamë të gjerë të grupeve të interesit që veprojnë në ujërat detare. Në një zonë që është kaq e vështirë për t'u patrulluar e kontrolluar, bashkëpunimi është thelbësor për suksesin e masave të propozuara të ruajtjes.



## 4.2 Ruajtja e fokave ne Greqi

### 4.2.1 Të përgjithshme

Kohë më parë, foka mesdhetare ishte e pranishme në të gjithë Detin Mesdhe, Detin Marmara dhe Detin e Zi. Ajo ka frekuentuar edhe brigjet Afrikane të Atlantikut, deri në Senegal dhe ishujt oqeanikë të Cape Verde, Madeira, Kanarie dhe Azores. Por, kohët e fundit, foka është zhdukur nga pjesa më e madhe e zonës së saj të mëparshme të përhapjes, ndërkohë që tkurrja dhe fragmentimi më i madh ka ndodhur gjatë 50 viteve të fundit.





Rrjeti - NATYRA 2000



Shkaqet kryesore të këtij degradimi janë vrasja e qëllimshme e fokave nga peshkatarët, kapja e rastësishme në mjetet e peshkimit, mungesa e ushqimit dhe shkatërrimi i habitateve të tyre, veçanërisht vendeve të tyre të shumimit. Efektet kanë qenë aq të rënda sa foka mesdhetare është tani një nga gjitarët më të kërcënuar në botë. Vlerësohet se kanë mbetur jo më shumë se 300-500 individë brenda tre popullatave të izoluara, dy prej të cilave janë në Atlantikun Verilindor, (ishulli Desertas Grande në Madeira dhe Cabo Blanco përgjatë bregut të Mauritanisë), ndërsa e treta gjendet e shpërndarë midis ishujve grekë të deteve Egje dhe Jon. Popullata greke është deri tani më e madhja, me 200-250 individë

#### 4.2.2 Identifikimi dhe ruajtja e zonave Natura 2000

LIFE-Nature ka kontribuar rreth 2.8 milionë euro në dy projekte të njëpasnjëshme të drejtuara nga Shoqëria Helenike për Studimin dhe Mbrojtjen e Fokës në Greqi. Projekti i parë në vitin 1997 synonte të zbulonte më shumë rreth shpërndarjes së kësaj kafshe të turpshme të izoluar, për të cilën deri atëherë, dihej shumë pak përtej bastionit të saj kryesor në Sporadet Veriore (tashmë shpallur një Park Kombëtar Detar).

Tetë zona të reja në detet Egje dhe Jon, të cilat mendohet se strehojnë foka, janë vëzhguar dhe monitoruar gjatë një periudhe trevjeçare. Kjo zbuloi praninë e 67-92 individëve. Një zonë rreth ishujve Polliagios-Kimolos doli të ishte e dyta



më e madhe në Greqi dhe në BE. Përqendrimet e individëve të këtij lloji ishin mjaft të rëndësishme për të nxitur përcaktimin dhe zgjerimin e dy zonave të tjera Natura 2000 për fokën mesdhetare në Greqi, rezultat i drejtpërdrejtë i këtij projekti.

Gjatë vëzhgimeve në terren u mblodhën informacione edhe për ekologjinë dhe mjedisin ky jeton kjo specie, u identifikuan vendet kryesore të shumimit (zakonisht shpella të paarrishme larg aktiviteteve njerëzore), u monitoruan zakonet e të ushqyerit, u analizuan kërcënimet dhe u regjistrua shkalla e vdekshmërisë. Kjo mori të dhënash të reja u përdor për të hartuar plane të detajuara menaxhimi për gjashtë nga zonat e reja në konsultim me autoritetet përkatëse lokale dhe kombëtare si dhe grupet e aktërëve të interesuar.

#### 4.2.3 Mbrojtja e vendeve

Duke ndihmuar në krijimin e elementeve bazë të një rrjeti zonash të mbrojtura për fokat në Greqi, si pjesë e rrjetit Natura 2000, projekti i dytë LIFE-Nature i çoi gjërat një fazë më tej duke zbatuar disa nga aktivitetet kryesore të propozuara në planet e menaxhimit për dy nga zonat e reja. Duke u fokusuar në ishujt Polliagios-Kimolos dhe kompleksin Karpathos-Saria në Egjeun e Jugut, të cilët strehojnë përkatësisht rreth 40 dhe 20 individë, projekti synon të trajtojë problemin e vrasjeve të qëllimshme



Rrieti - NATYRA 2000



dhe peshkimit të paligjshëm. Për dekada, fokat janë persekutuar nga peshkatarët vendas për “vjedhjen” e peshkut dhe dëmtimin e rrjetave.

Për arritjen e këtij objektivi, u konsideruan të nevojshme dy aktivitete, i pari ishte ngritja e një skeme të rregullt të mbrojtjes rreth zonave dhe shpellave të fokave dhe i dyti ishte zbatimi i një programi madhor ndërgjegjësues që synonte banorët vendas, turistët dhe peshkatarët.

Një ekip i përkushtuar i rejnXHersave lokalë u rekrutua për secilën zonë dhe iu dha trajnimi për teknikat e mbikëqyrjes nga Parku Kombëtar të Sporades. Më pas atyre iu dha një plan i detajuar mbikëqyrjeje dhe pajisjet e nevojshme për të kryer me efektivitet punën e tyre (skafe të shpejtë, dylbi, formularë monitorimi etj).

Në fund të projektit ata kishin shpenzuar mbi 500 ditë duke vëzhguar rreth 40 shpella dhe ujërat përreth që përdoren shpesh nga fokat. Nga këto vëzhgime u raportuan aktivitete të paligjshme dhe u mblodhën informacione të detajuara mbi aspekte të ndryshme të sjelljes dhe kërcënimeve ndaj kësaj speciej. Përveç kësaj, prania e rregullt e rejnXHersave u mundësoi atyre të flisnin me shumë njerëz të ndryshëm për statusin e rënduar të fokës dhe të siguronin pranim dhe mbështetje për ruajtjen e tyre.



Projekti hartoi gjithashtu një strategji komunikimi më të gjerë që synonte publikun në përgjithësi. Objektivi kryesor ishin “zemrat dhe mendjet” e banorëve vendas pasi mbrojtja afatgjatë e këtij lloji varet kryesisht nga qëndrimet lokale. Për këtë u përdorën një gamë e tërë teknikash të ndryshme si prezantimet në shkollat lokale, fletëpalosje, postera, ekspozita lokale, konkurse dhe lojëra për fëmijë deri te spotet televizive, intervistat në radio dhe mbulimi mediatik mbarëkombëtar. Gjithashtu u ndërtuan dy qendra të vogla informacioni për të krijuar një bazë për mbledhje, ekspozita, ditë të hapura etj., dhe për të shërbyer si një “pikë takimi” për banorët vendas.

Deri në fund të projektit, u pa qartë se këto aktivitete ishin të suksesshme. Qëndrimet lokale ndaj fokave kishin ndryshuar ndjeshëm - ato nuk konsideroheshin më thjesht një kërcënim, por më tepër një pasuri për ishujt për sa i përket potencialit të eko-turizmit, dhe shiheshin me një ndjenjë krenarie. Elementi lokal i projektit ishte thelbësor për suksesin e tij. Kjo vërtetohet nga fakti se nuk ka pasur më vrasje të paligjshme të fokave në të dy zonat dhe lindjet e këlyshëve të vegjël kanë qenë të qëndrueshme gjatë gjithë projektit.





Rrieti - NATYRA 2000



## 4.3 Dialogu mes aktorëve në ujërat Spanjolle

### 4.3.1 Të përgjithshme

Ujërat territoriale spanjolle përfshijnë pjesën jugore të Gjirit të Biscay, një pjesë të madhe të Detit Mesdhe dhe pjesë të mëdha të ujërave të Atlantikut në jugperëndim të Spanjës dhe Kanarie. Me një zonë detare kaq të larmishme, e cila përfshin mjedise afër bregut dhe në det të hapur, qeveria spanjolle ka një përgjegjësi të veçantë për ruajtjen e specieve detare migratore, duke përfshirë breshkat dhe cetacet.

Projekti i parë "Ruajtja e breshkave dhe delfinëve në Ishujt Kanarie" në vitin 1997 u promovua nga Departamenti i Ministrisë Rajonale të Politikës Territoriale të Qeverisë së Kanarie. Projekti synoi të identifikojë zonat kryesore detare të frekuentuara nga cetacet dhe breshkat e detit dhe të rregullojë disa aktivitete që ndikojnë negativisht ndaj tyre.

Pas një vëzhgimi të gjerë dhe mbledhjes së të dhënave, u bë e qartë se ujërat përreth Kanarieve janë ndër më të pasurat në BE për numrin e delfinëve hundë të shishe (rreth 1000 individë). Disa zona të reja u identifikuan si mjaft të rëndësishme për këtë lloj. Si rezultat, kufijtë e zonave detare ekzistuese Natura 2000 u ndryshuan në funksion të rezultateve të studimit të ri duke përditësuar të dhënat për të pasqyruar praninë e delfinëve në zonat detare ekzistuese.

Projekti adresoi edhe problemin e vrotjimit të balenave, i cili po shndërrohet në një industri të rëndësishme në Kanarie, duke sjellë mbi 30 milionë euro në vit. Duke studiuar aspektet biologjike si dhe socio-ekonomike të kësaj industrie në zhvillim, projekti hartoi një sërë masash që rregullojnë operacionet e vrotjimit të balenave, për të siguruar që ato të mos shqetësojnë më shumë seç llojet në fjalë. Në fund të projektit u miratua një ligj i ri, i cili shtrëngon rregullat për funksionimin e bizneseve të vëzhgimit të balenave.

### 4.3.2 Puna me aktorët përgjatë bregdetit jugor të Spanjës

Një projekt i dytë LIFE, këtë herë në zonat detare rreth bregut jugor të Spanjës, u përqendrua më shumë në zhvillimin e planeve të menaxhimit në bashkëpunim me palët e interesuara lokale. Gama e interesave në mjedisin detar priret të jetë shumë e larmishme dhe e pakoordinuar, gjë që e bën këtë një proces domosdoshmërisht kompleks dhe delikat. Për më tepër, pak nga palët e interesuara kishin përvojë të mëparshme në çështjet e ruajtjes së mjedisit detar, ndaj po fillonin nga një bazë shumë e kufizuar informacioni. Kështu, çdo përpjekje për të ndryshuar praktikën ose qëndrimet ekzistuese duhet shoqëruar patjetër nga një fushatë e fokusuar informimi për aktorët e interesuar për çështjet në fjalë dhe ndikimet e mundshme për ta.

Kjo u realizua me një sukses të konsiderueshëm përgjatë bregdetit jugor të Spanjës. Fillimisht, Shoqëria Spanjolle për Cetacea-t kishte identifikuar disa zona detare që mund të shpallen si zona Natura 2000 përgjatë ngushticës që lidh Mesdheun me Atlantikun. Megjithatë, ajo vërejti se, pa një dialog të gjerë, mbrojtja e këtyre zonave do të haste në rezistencë të madhe nga grupet e aktorëve vendas, të cilët, në mungesë të informacionit, do të ndjenin jetesën e tyre të kërcënuar padrejtësisht.



Rrieti - NATYRA 2000



Për këtë qëllim, shoqata filloi një fushatë të madhe ndërgjegjësimi që synonte të gjitha grupet e mundshme të aktorëve të interesuar përgjatë bregdetit. Qëllimi fushatës ishte të shpjegonte përse detet e pasura rreth Andaluzisë dhe Murcias kishin nevojë për mbrojtje dhe angazhim të grupeve të ndryshme të aktorëve në diskutime mbi mënyrat e ruajtjes së këtyre vlerave natyrore duke respektuar nevojat e tyre socio-ekonomike.

Duke filluar nga viti 2002, tre anije të vjetra me vela udhëtuan përgjatë bregdetit, duke u ndalur në 19 porte gjatë rrugës për të ofruar një seri të gjithanshme eventesh, bisedash, aktiviteteve dhe ekskursionesh që synonin aktorët lokalë. Udhëtimi i parë kishte të bënte me rritjen e ndërgjegjësimit – informimin e njerëzve për rëndësinë e zonave të mbrojtura detare dhe kërcënimet kryesore ndaj tyre. Udhëtimi i dytë, një vit më vonë, e çoi procesin një hap më tej dhe angazhoi aktorët lokalë në diskutime mbi mbrojtjen e këtyre burimeve të vlefshme, veçanërisht në fushën e konflikteve të mundshme me aktivitetet ekzistuese njerëzore.

Udhëtimi i fundit, synonte arritjen e një konsensusi për projekt-planin e menaxhimit, të cilat janë përgatitur në bazë të një procesi të gjerë konsultimi. Përveç aktiviteteve që lidhen me fushatën e përgjithshme të informacionit, për të çuar përpara procesin, u zhvilluan edhe takime formale me grupet e aktorëve të interesuar në vende strategjike përgjatë bregdetit.

Diskutimet u zhvilluan në frymën e bashkëpunimit dhe dialogut konstruktiv. Fakti që të gjithë tani janë plotësisht të vetëdijshëm për çështjet në fjalë, do të thotë se ata mund të përqendrohen në gjetjen e zgjidhjeve praktike në zona specifike të konfliktit pa vënë në pikëpyetje të gjithë konceptin e zonave të mbrojtura detare.

Megjithëse kundërshtimet ndaj shpalljes së zonave të mbrojtura nuk mund të përjashtohen, natyra gjithëpërfshirëse e punës përgatitore ndihmon në pranimin lokal të kufizimeve të mundshme ndaj aktiviteteve. Kërcënimet që u trajtuan përfshijnë praktikën e papërshtatshme të peshkimit (veçanërisht të dëmshme për breshkat), peshkimin e paligjshëm, ndotjen akustike dhe ndotjen detare, dhe aty ku do të ketë kufizime, projekti do të inkurajojë aktivitete të reja ekonomike, të tilla si vrotimi i balenave.

## 5 Lumenjtë

### 5.1 Të përgjithshme

Shumica e lumenjve të Evropës kanë pësuar ndryshime të mëdha fizike gjatë 200 viteve të fundit. Ata janë kanalizuar, drejtuar, thelluar, argjinuar, ndotur dhe bllokuar me diga, etj. Zonat e përmytjeve, të pasura me aluvione të lidhura me këta lumenj janë pakësuar gjithashtu në mënyrë dramatike për t'i hapur vend tokave bujqësore dhe veprave për parandalimin e përmytjeve. Megjithatë, pavarësisht këtyre ndryshimeve dramatike, fragmente të habitateve origjinale gjysmë-natyrore lumore ekzistojnë ende, duke siguruar strehë për një grup veçanërisht të pasur bimësh dhe kafshësh mbijetesa e të cilave varet nga këto zona natyrore.





Rrjeti - NATYRA 2000



Shumë lloje habitatesh aluvionale janë renditur tashmë në Direktivën e Habitave dhe mbrohen përmes rrjetit Natura 2000. Megjithatë, për shkak të natyrës së tyre komplekse, ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i tyre kërkon një qasje të integruar të menaxhimit në të gjithë gjatësinë e lumit dhe zonën e pellgut ujëmbledhës.

Miratimi në vitin 2000 i Direktivës Kuadër për Ujërat ka prezantuar pikërisht një mekanizëm të tillë ligjor për të siguruar një qasje strategjike për menaxhimin e pellgjeve lumore nëpër lumenj të ndryshëm të Evropës, pavarësisht nga kufizimet dhe kufijtë sektorialë, administrativë ose kombëtarë. Këto plane të menaxhimit të pellgjeve lumore do të marrin parasysh plotësisht dispozitat e Direktivës së Habitave.

## 5.2 Vendosja e bazës sociale për rehabilitim Lumi Ain, Francë

### 5.2.1 Të përgjithshme

Lumi Ain është një nga degët e lumit Rhône, që rrjedh nga Alpet Franceze për tu takuar me lumin Rhône në një deltë të madhe në brendësi të territorit francez. Pjesa e poshtme e tij, midis maleve dhe lumit Rhône, ka të gjitha karakteristikat e një lumi fushor, me pyje aluvionalë dhe një numër kanalesh të dikurshme, të cilat janë pak a shumë të shkëputura nga rrjedha kryesore e lumit.

Problemi është se digat e hidrocentraleve dhe guroret e zhavorrit në rrjedhën e sipërme, në pjesën malore të lumit, prishin ndjeshëm dinamikën e tij natyrore në rrjedhën e poshtme, duke shkaktuar rrjedha të parregullta ujore dhe ngarkesa sedimentesh më të lehta se normale. Meqenëse ka



shumë pak ujë dhe material të trashë që kalon periodikisht nëpër meanderat e dikurshëm, ato po mbushen ngadalë me sedimente, duke humbur aftësinë e tyre për të strehuar lloje të Aneksit II të Direktivës së habitave, si bima ujore. *Lurionium natans*. Kjo nuk është një e keqe vetëm për natyrën,



por edhe për turizmin lokal dhe fermerët që varen nga furnizimi i vazhdueshëm me ujë i lumit.

### 5.2.2 Puna në partneritet

Në një përpjekje për të zgjidhur këtë problem, Zyra Rajonale e ruajtjes së natyrës në provincën Rhone-Alpe bashkoi forcat me Unionin e Bashkive Lokale për të rivendosur dinamikën natyrore të lumit në përputhje me një strategji të dakorduar menaxhimi për këtë pjesë të lumit. Unioni përfaqëson gjithsej 40 bashki breglumore,



Rrieti - NATYRA 2000



nga të cilat 21 janë në zona të Natura 2000, dhe kështu përfaqëson një partner ideal për të fituar mbështetjen e publikut në një zonë kaq të madhe dhe komplekse me shumë përdorime. Megjithatë, Unionit i mungonte ekspertiza e nevojshme teknike dhe kështu u interesua për bashkëpunimin e Zyrës Rajonal të Ruajtjes së Natyrës, e cila kishte jo vetëm njohuritë teknike, por edhe përvojën e duhur në aplikimin për fondet evropiane, si LIFE-Nature. Kryetarët lokalë dhe përfaqësuesit e tjerë të zgjedhur vendorë u kënaqën nga interesimi i treguar për luginën e tyre, kur mësuan se projekt-propozimi i tyre kishte qenë i suksesshëm.

Së pari, projekti kreu një mori studimesh për të marrë një pamje të qartë dhe të detajuar të situatës në terren dhe për të gjetur zgjidhje të mundshme. Përveç një analize të plotë të të gjithë sistemit lumor të Ain-it të poshtëm dhe hidrodinamikës së tij, studimet vlerësuan përdorimet rekreative të lumit dhe ekosistemeve të lidhura me të, habitatet dhe llojet me interes për Natura 2000, situatën e pyjeve aluvionale dhe nevojat për një sistem monitorimi në të ardhshmen.

Në veçanti, inventarizimi i habitateve dhe llojeve rezultoi me shumë informacione të dobishme, pasi i u identifikuan jo më pak se 15 habitate të Aneksit I dhe 13 lloje të Aneksit II, dhe rezultatet e inventarizimit çuan në propozime për zgjerimin e kufijve të zonës Natura 2000 në përputhje me zbulimet e reja. Informacioni nga studimet u përdor për të përgatitur një plan menaxhimi për zonën e poshtme të lumit Ain, si zonë Natura 2000.

Aktivitetet e tjera në kuadër të projektit përfshijnë gërmimin e meandreve të vjetra të lumenjve për të nxitur një rrjedhje të lirë të ujit nëpër to, apo lidhjen e gropave të mbushura me ujë të guroreve të zhavorrit me lumin Ain për të krijuar më shumë "habitate ujore të qeta". Megjithatë, shkaku kryesor i mbushjes së kanaleve anësore nuk duhet të injorohet. Studimet kanë treguar se mungesa e sedimenteve dhe zhavorrit të bartur nga lumi Ain, si rezultat i digave në rrjedhën e sipërme, është me të vërtetë shkaku kryesor i këtij fenomeni. Rreth 17,000 m<sup>3</sup> sediment shtesë ndaj ngarkesës aktuale do të nevojiteshin për të pasur një efekt ekologjik optimal.

Informacioni i mbledhur përmes projektit është përdorur edhe në diskutimet me aktorët lokalë dhe bashkitë, për të gjetur mënyrën se si të lejohet që lumi të rikuperojë zonën që dikur përmbyste, gërryente dhe depozitonte sedimente. Një nga objektivat më të rëndësishëm është që të lejohet lumi që të kthehet në zonën e tij të përmytjes sa më shumë që të jetë e mundur. Faktikisht, 85% e zonës së përmytjes është tokë në pronësi publike, me bashkitë si pronarë kryesorë.

Projekti negocioi marrëveshje dhjetëvjeçare me 21 bashkitë e interesuara, në të cilat ato pranojnë që lumi mund të përmytë periodikisht tokat e tyre dhe se proceset e erozionit nuk do të pengohen. Sa i përket tokës private në zonën e përmytjes, projekti do të blejë pjesët ku duhet të lejohet erozioni nga lumi.

Pjesë e paketës janë edhe marrëveshjet për pyjet aluvionale përgjatë lumit. Zyra Kombëtare e Pyjeve (ONF), ka përgatitur një strategji koherente dhe gjithëpërfshirëse për menaxhimin e këtyre pyjeve, të cilat në mënyrë ideale duhet të ndjekin proceset natyrore aluvionale. Për këtë, parashikohet një rrjet rezervash biologjike në pyjet aluvionale, ndërkohë që 50 ha pyje të degraduar do të rehabilitohen në një status më të mirë ruajtjeje.





Rrieti - NATYRA 2000



### 5.2.3 Ndërgjegjësimi i publikut

Pavarësisht se sa i mirë mund të jetë koncepti gjithëpërfshirës apo sa novatore të jenë propozimet teknike, nëse banorët vendas që jetojnë përgjatë lumit nuk janë dakord, do të jetë jashtëzakonisht e vështirë për t'i realizuar ato. Ndoshta aspekti më domethënës i këtij projekti është puna e tij në terren me komunitetin. Përveç negociatave dhe konsultimeve me organet vendore dhe grupet e aktorëve të interesuar të përshkruara më sipër, ai iu është drejtuar drejtpërdrejt edhe qytetarëve individualë.

Projekti vendosi të nisë me një ngjarje mediatike të profilit të lartë për të tërhequr vëmendjen për faktin se partneriteti i sapoformuar do të gjeneronte zgjidhje praktike dhe të prekshme. Projekti pastroi 24 km të brigjeve të lumit nga mbeturinat. Çdo komunë u angazhua për të reklamuar këtë ngjarje dhe për të rekrutuar vullnetarë. Gjithashtu, iu dërguan ftesa 27,000 familjeve në zonë. Pjesëmarrja ishte e konsiderueshme me mbi 600 njerëz që erdhën për të ndihmuar në pastrimin e mbi 12 tonëve mbeturina.

Ky aksion u prit shumë pozitivisht në zonë, pasi u pa si një përpjekje e prekshme për të bërë diçka për mjedisin dhe për shkak se u pasqyrua gjerësisht në gazetatat lokale. Në shumë pak kohë të gjithë u njohën me projektin për "lumin e tyre".

Një pjesë shumë e rëndësishme e menaxhimit të lumit në të ardhmen ka të bëjë me përdorimin rekreativ. Projekti LIFE përgatiti një koncept për menaxhimin e përdorimit rekreativ dhe të vizitorëve. Nga njëra anë, ai parashikon kufizimin e aksesit në zonat veçanërisht të ndjeshme, në fund të cilave do të ngrihen rreth 80 barriera. Nga ana tjetër, ai do të reklamojë vlerat e natyrës së lumit dhe habitateve të tij aty ku është e përshtatshme, duke ofruar shtigje për ecje në natyrës dhe panele informacioni.

### 5.2.4 Rivendosja e dinamikës natyrore në lumin Danub



Seksione të mëdha të Danubit dhe degëve të tij kryesore janë rrethuar nga argjinatura artificiale për stabilizimin e brigjeve të lumit, duke prerë kanalet anësore, duke privuar pyjet aluvionale nga uji i përmytjeve dhe duke çuar në thellimin e vazhdueshëm të shtratit kryesor të lumit, çka sjell uljen e nivelit të ujit nëntokësor në gjithë zonën e përmytjes. Heqja e argjinaturave përgjatë brigjeve i jep

lumit mundësinë për të rikthyer dinamikën e tij normale të përmytjeve, erozionit dhe sedimentimit duke riparuar gradualisht dëmtimet në habitatet e tij në zonën e përmytjes.

Bazuar në një koncept për të rilidhur gropëzat e ndryshme me ujë të ndenjtur në zonën e përmytjes me shtratin kryesor të lumit, projekti LIFE-Nature Donau-Auen përpunoi plane teknike të detajuara dhe realizoi të parat rilidhje të tilla në Orth dhe Untere Lobau. Këto përfshijnë uljen e argjinaturës në



Rrieti - NATYRA 2000



disa pika dhe ndryshimin e pendave nëpër grykëderdhjet e kanaleve anësore, në mënyrë që të rrjedhë më shumë ujë në këto kanale anësore dhe në pyjet aluvionale e gropat me ujë të ndenjur.

Është e qartë se kjo rivitalizoi ekosistemin e zonës së përmytjes duke ndihmuar habitatet ligatinore dhe llojet që strehohen në to, si peshku *Umbra krameri*, i cili konsiderohej i zhdukur në Austri deri në rizbulimin e tij në 1992. Paradoksalisht, projekti i shërbeu edhe qëllimit shumë praktik të mbrojtjes së Vjenës nga përmytjet. Në vend që të ndiqte metodat konvencionale duke forcuar argjinaturat, lumit iu dha më shumë hapësirë për t'u shtrirë. Argjinaturat më afër lumit u ulën në mënyrë që zona e vjetër e përmytjes të shndërrohej në një pellg mbajtës dhe ujërat e përmytjeve të shtrihen deri në argjinaturat më në brendësi.

### 5.3 Një koncept gjithëpërfshirës për menaxhimin e lumenjve

#### 5.3.1 Të përgjithshme



Projekti pati një efekt të rëndësishëm demonstrues dhe mësimor. Përpara projektit, autoritetet e kishin testuar këtë metodë në seksione të vogla përgjatë lumit, por projekti i dha mundësinë për të realizuar këto masa rehabilitimi në shkallë më të gjerë. Ata u treguan të suksesshëm dhe tani, pas projektit, të gjitha masat inxhinierike përgjatë bregut Austriak të Danubit jo vetëm që duhet të kontrollohen për ndikimin e tyre në natyrë, por duhet të jenë gjithashtu në përputhje me

"Gesamtkonzept" (Koncepti Gjithëpërfshirës) për lumin Danub në lindje të Vjenës.

Sipas këtij koncepti, brenda dekadave të ardhshme gjysma e argjinaturave artificiale përgjatë lumit do të çmontohet, hidrologjia e zonës së përmytjes do të restaurohet dhe njëkohësisht do të mirëmbahet kanali i transportit në Danub.

#### 5.3.2 Një koncept gjithëpërfshirës për menaxhimin e lumenjve

Projekti LIFE i mundësoi autoriteteve të testonin masa të reja restauruese hidrologjike, të cilat u përfshinë drejtpërdrejt në këtë koncept gjithëpërfshirës dhe për këtë arsye u kthyen në standard për masat e restaurimit të lumit përgjatë bregut austriak të Danubit.







Rrieti - NATYRA 2000



Në projektin Donau-Ufer, "Koncepti Gjithëpërshires" u zbatua më tej. Të gjithë elementët artificialë që forcojnë bregun u hoqën në një seksion pilot prej 2.8 km të bregut të Danubit përballë qytetit të Hainburgut, në mënyrë që proceset e erozionit dhe depozitimit të çojnë përsëri në formimin e brigjeve natyrore të lumit. Për këtë qëllim do të duhet të hiqen rreth 24,000 m<sup>3</sup> blloqe guri.

Brenda pak vitesh, pasi të përfundojë puna, lumi pritet të gërryejë bregun e pjerrët për të formuar një breg të cekët e të shkallëzuar lehtësisht, me shkëmbinj rastesore. Këta dhe elementë të tjerë të rrallë të peizazhit të zonës së përmytjes do të formohen sërish drejtpërdrejt përgjatë rrjedhës kryesore të lumit Danub.

### 5.3.3 Projekte plotësuese përgjatë Danubit



Projekti Wachau, në rrjedhën e sipërme të Vjenës, përfshin një aktivitet pilot për të rikrijuar brigjet e zhavorrit dhe ishujt në Danub, duke përdorur 400,000 m<sup>3</sup> zhavorr të gërmuar çdo vit nga kanalet e transportit në atë seksion lumi. Këto struktura zhavorri do të shërbejnë si vend riprodhimi për peshqit dhe si vend pushimi dhe ushqimi për shpendët ujorë.

Duke mos harruar tributarët, projekti March-Thaya përpunoi një koncept gjithëpërfshirës të rigjenerimit për lumin March dhe filloi zbatimin e tij, duke ofruar një fillim të mbarë për rivendosjen e proceseve dinamike të lumit (erozioni, sedimentimi, gjarpërimi) në një seksion prej 10 km përgjatë kufirit me Sllovakinë. Projekti krijoi struktura pothuajse natyrore të bregut të lumit (duke siguruar habitate të reja për shumë specie tipike bimore dhe shtazore) dhe përmirësoi lidhjen midis meandreve të ndërprerë dhe rrjedhës kryesore të lumit, duke siguruar vende të sigurta me ujë të qëndrueshëm për peshqit gjatë përmytjeve.

## 6 Kullotat

### 6.1 Të përgjithshme

Një nga aspektet dalluese të natyrës në Evropë, krahasuar me Amerikën e Veriut ose pyjet tropikale, është se një pjesë e konsiderueshme e saj është e lidhur ngushtë me bujqësinë. Këtu përfshihen livadhet e kullotat dhe habitate të tjera kryesisht me bimësi barishtore. Në të gjitha këto lloje habitatesh kemi të bëjmë me komunitete vegjetacioni të cilat tentojnë të evoluojnë me kalimin e kohës në komunitete të tjera, zakonisht shkurre dhe përfundimisht pyjore. Në kohët e hershme, habitate të tilla krijoheshin si rezultat i katastrofave natyrore (zjarret, përmytjet dhe erozioni, stuhitë) ose ndoshta nëpërmjet veprimit të barëngrënësve të mëdhenj. Ato ekzistonin për një kohë dhe më pas zhdukeshin përsëri, derisa cikli i ardhshëm i ngjarjeve të favorizojë rishfaqjen e tyre.



Rrieti - NATYRA 2000



Gjatë mijëra viteve të fundit, ndërtimi i vendbanimeve për njerëzit dhe përdorimi i tokës për bujqësi e ka rritur shumë sipërfaqen e habitateve të tilla në Evropë dhe, nëpërmjet kullotjes nga bagëtitë, kositjes ose djegies për rritjen e kulturave me rotacion, i ka ruajtur që ato të mos evoluojnë në mënyrë natyrore në shkurre apo formacioone pyjore. Kështu, një shumëllojshmëri livadhesh dhe kullotash kombinuar me shkurreta të ulëta janë bërë aspekte tipike të peizazheve tradicionale evropiane.

Ato jo vetëm që janë një trashëgimi natyrore më vete, por gjithashtu strehojnë një sërë llojesh bimore dhe shtazore që janë përshtatur me këto habitate. Disa lloje shpendësh, për shembull, me origjinë nga stepat natyrore të Azisë Qendrore, si pula mjekëroshe (*Otis tarda*), janë përshtatur në tokat bujqësore dhe kullotat e hapura të krijuara nga fermerët dhe kanë ndjekur vendbanimet njerëzore në Evropën Qendrore dhe Perëndimore.

Problemi është se përdorimet tradicionale të tokës që kanë mbështetur këto habitate dinamike dhe llojet që vareshin prej tyre ndër shekuj, janë nën kërcënim nga ndryshimet në praktikat bujqësore dhe strukturat ekonomike rurale. Në mënyrë të përmblodhur, mund të përmendim:

- **Braktisja:** Kullotat nuk kulloten apo kositen më; shkurretat nuk shfrytëzohen më tradicionalisht; suksesioni natyror sjell ritjen e shkurreve dhe drurëve pyjorë. Kjo ndodh kur fermerët humbasin interesin pasi përfitimi ekonomik nuk e justifikon mundin, bari zëvendësohet me foragjere si misri ose ushqime industriale, kullotja në natyrë zëvendësohet nga regjimi stallor. Bujqësia fokusohet në aktivitete të tjera në toka më të afërta ose shuhet fare (shpopullimi i zonave rurale).
- **Intensifikimi:** Kullotat “përmirësohen” duke kulluar, lëruar, mbjellë, plehruar, etj., me qëllim që të ketë më shumë kositje në vit dhe rendimente më të larta. Kullota të tilla agro-industriale kanë vlerë të ulët biodiversiteti. Këtu kemi një situatë e cila është e kundërta e braktisjes – në vend të rënies së bujqësisë, ka stimuj të fortë për të nxitur prodhimin.
- **Konvertimi:** Kullotat gjysëm-natyrore, shkurretat, etj shndërrohen në përdorime të tjera të tokës, si: pyje (pyllëzim me monokultura halore me biodiversitet të ulët), toka bujqësore, vreshta, zona banimi, gurore, zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme.
- **Praktika ekologjikisht të papërshtatshme:** Kositja në datat e gabuara, për shembull, mund të shqetësojë shumimin e shpendëve ose të favorizojë lloje të caktuara bimore në dëm të të tjerëve.

Rrjeti Natura 2000 përfshin shumë zona të cilat janë shpallur për të ruajtur kullotat, shkurretat apo habitate të tjera dinamike, gjysmë natyrore të listuara në Aneksin I të Direktivës së Habitaveve si dhe/ose për speciet që mbështeten në to. Prandaj, është jetike për menaxherët e zonave Natura 2000 që të krijojnë partneritete me fermerët dhe të gjejnë mënyra për të rivendosur ose vazhduar përdorimet tradicionale të tokës dhe praktikat që garantojnë një status të favorshëm ruajtjeje ndaj vlerave të Natura 2000, por pa cenuar të drejtën e fermerëve për të siguruar jetesën.





Rrieti - NATYRA 2000



## 6.2 Testimi i metodave të përshtatshme të përdorimit të tokës për kullotat dhe shpendët në Spanjë



Kullotat e Spanjës përmbajnë lloje të rralla habitatesh dhe një mori shpendësh të Aneksit I, disa prej tyre të rrezikuar. Kullotat, të cilat ia detyrojnë biodiversitetin e tyre rritjes tradicionale jo intensive të drithërave dhe kullotjes së deleve, janë nën kërcënimin e dy proceseve të kundërta. Në disa zona, bujqësia është braktisur fare, në të tjera vërehet intensifikimi dhe mbikullotja.

Në dy projekte LIFE-Nature, Departamenti i Ruajtjes së Natyrës të Qeverisë Rajonale të Extremadurës dhe shoqata Sociedad Española de Ornitología (SEO/Birdlife), testuan modele të ndryshme menaxhimi në fermat bujqësore për të gjetur modele të bujqësisë së

qëndrueshme ekologjikut. Qëllimi ishte të përmirësohej statusi i ruajtjes së habitateve dhe specieve Natura 2000 të kullotave La Serena me ndihmën e fermerëve vendas.

Në projektin e SEO, u zgjodhën dy ferma, të zgjedhura për vlerën e tyre për shpendët, dhe u arrit një marrëveshje me pronarët që fermat do të menaxhoheshin gjatë projektit sipas udhëzimeve ekologjike. Të dhënat nga këto dy ferma pilot u krahasuan me dy ferma të tjera kontrolli, të cilat qëndruan nën menaxhim konvencional. Sipas marrëveshjes, fermerët kryenin punën e tyre nën mbikëqyrjen teknike të ekspertëve të shoqatës, në këmbim të një kompensimi për përpjekjet e tyre.

Në dy fermat pilot, pjesa më e madhe e tokës (300-400 ha në çdo fermë) mbahej për bagëtitë, por dendësia u ul nga 3 në 1.5 dele/ha (një reduktim 50% i tufave ekzistuese). Pjesa e mbetur e tokës (gjithsej 265 ha) ishte caktuar për kultivimin e drithërave duke përdorur një sistem tradicional rrotacioni.

Kjo pjesë ndahej në tre ose katër parcela, të cilat rrethoheshin e kultivoheshin me rradhë (rrotacion) (një pjesë lihej djerrë, lërohej, mbillej një ose dy herë) në një cikël tre ose katër vjeçar. Rrotacioni lejoi që shpendët e ndryshëm të përdorin territorin sipas preferencave të tyre për toka djerrë apo të kultivuara. Nevojat e llojeve të ndryshme të shpendëve u morën parasysh edhe gjatë përcaktimit të kalendarit të punëve bujqësore (nuk ka korrje para datës 20 Qershor, nuk ka plugim midis 1 Marsit dhe 30 Shtatorit). 25% e sipërfaqes i është dedikuar kultivimit të përzier të drithërave dhe bishtajore

ve (tërshërë/grashina). Kjo sipërfaqe nuk korret por lihet në fushë, në mënyrë që të ofrojë ushqim për shpendët. Në fermat pilot nuk u përdorën plehra kimike.





Rrieti - NATYRA 2000



Numërimi i rregullt i shpendëve (6 herë në vit) lejoi që fermat të krahasoheshin me fermat e kontrollit për sa i përket numrit të llojeve dhe preferencave për habitate të ndryshme. Analiza e rezultateve tregoi se:

- Fermat e menaxhuara kishin një numër më të madh llojesh.
- Dendësia e këtyre llojeve u rrit gjatë zbatimit të projektit.
- Modeli i menaxhimit sjell proporcionalisht përfitime më të mëdha për skifterin kthetraverdhë, pulën mjekroshe dhe pulën e vogël të livadheve.
- Toka e djerrë preferohet më shumë se tokat e kultivuara nga shumica e llojeve të studiuara.
- Tokat e mjella me drithëra preferohen nga pula mjekroshe dhe pula e vogël e livadheve gjatë zbatimit të projektit, në fermat e menaxhuara është ulur ndjeshëm dëmtimi nga grabitqarët, çka mund të lidhet pjesërisht me mbulesën dhe lartësinë e bimësisë.



Gjithashtu u krahasua edhe ecuria ekonomike e fermave. Bazuar në dy fermat e menaxhuara, ky studim vlerësoi një rënie të të ardhurave prej 33.99 € për dele dhe 20.35 €/ha tokë arë. Prandaj, për të bërë të zbatueshëm këtë model menaxhimi nevojitet mbështetje financiare nga masat agromjedisore.

Projekti i dytë u zbatua nga qeveria rajonale dhe ishte shumë më i gjerë. Ai bëri një analizë të plotë të densitetit të bagëtive dhe kapacitetit mbajtës në 17 ferma dhe arriti marrëveshje me 23 ferma për të modifikuar aktivitetet bujqësore për të mirën e shpendëve. Këto marrëveshje ishin në baza vjetore, të rinovueshme në funksion të pranisë së shpendëve në secilën fermë. Marrëveshjet përfshinin masa të tilla si:

- shtyrje e datës së korrjes (kryesisht në zona me densitet të lartë folezimi, për të siguruar strehë gjatë riprodhimit)
- copëza të pa korrura (kur dendësia e foleve është më e ulët)
- lënie e zonave kufitare pa korrur (duke diversifikuar habitatet e disponueshme)
- mbjellja e bishtajoreve (sigurojnë burim shtesë ushqimi)
- ndalimi përkohësisht i kullotjes për të shmangur shqetësimin e shpendëve gjatë periudhës së shumimit – kryesisht në zonat e shfaqjes gjatë çiftëzimit (të ashtuquajturat “parada dashurie”).





Rrieti - NATYRA 2000



### 6.3 Efekti nxitës

Të dy projektet LIFE ndihmuan në promovimin e praktikave të qëndrueshme në zonë. Veprimet e ndërmarra shkaktuan debate dhe pritshmëri të reja mes fermerëve. Ato patën një efekt nxitës të rëndësishëm, pasi fermerët që nuk ishin të përfshirë në projekte aplikuan vullnetarisht disa nga masat e menaxhimit, pasi kishin parë rezultatet e marra me këto metoda alternative. Mbjellja e bishtajoreve ishte masa më popullore, pasi siguron ushqim shtesë për delet si dhe për shpendët në fund të verës kur kullotat nuk mund të përdoren. Fermerët shprehën synimin e tyre për ta vazhduar këtë praktikë edhe pas projektit.

Të dy projektet mblodhën së bashku palët e interesuara (administrata të ndryshme, shoqata të gjuetarëve dhe fermerëve dhe OJQ-të e ruajtjes së natyrës) në disa takime, duke lehtësuar dialogun, një aset kyç për vendimet e ardhshme mbi masat e menaxhimit që do të zbatohen në zonën Natura 2000. Në këto takime u diskutua edhe për problemet më të gjera me të cilat përballej bujqësia në rajon, si mungesa e interesit nga të rinjtë vendas për këtë profesion.

Gjatë këtyre takimeve, sektori i bujqësisë tregoi gatishmëri për të zbatuar praktika bujqësore në dobi të zonave Natura 2000, nëse do të vendoseshin skemat dhe rregulloret e përshtatshme të mbështetjes ekonomike në bazë të Politikës së Përbashkët për Bujqësinë apo instrumenteve të zhvillimit rural. Ky ndryshim i mentalitetit ishte një rezultat i drejtpërdrejtë i projekteve LIFE të kryera në La Serena. SEO po vazhdon punën bazuar mbi këto rezultate duke promovuar produkte fitimprurëse të siguruara përmes menaxhimit të qëndrueshëm ekologjik, si djathi i deleve me origjinë të përcaktuar apo turizmi i vrojtimit të shpendëve në ferma.

### 6.4 Përdorimi i ruajtjes së natyrës për të zhvilluar pika të reja shitjeje për produktet bujqësore në Rhön, Gjermani

#### 6.4.1 Të përgjithshme

Në Rhön (një zonë malore që shtrihet në Landet Gjermane të Turingisë, Hesenit dhe Bavarisë), qindra hektarë kullota të braktisura, me habitate të listuara në Aneksin I të Direktivës së Habiteteve, u rehabilituan nëpërmjet dy projekteve të njëpasnjëshme LIFE midis 1993 dhe 2002. Këto habitate kërcënoheshin nga përdorimi i pakët bujqësor. Në të kaluarën, në Republikën Demokratike Gjermane, këto kullota kulloreshin nga tufa të mëdha delesh, por pas kalimit në ekonominë e tregut, këto tufa, të cilat nuk mbroheshin më nga një treg i mbyllur me konsumatorë të garantuar, u zhdukën me shpejtësi.

Menaxherët e Rezervës së Biosferës Rhön u përpoqën që t'i mbanin fermerët ta përdornin këtë tokë, apo t'i kthenin ata sërish në tokat e braktisura. Kjo reflektonte dëshirën e Rezervës së Biosferës për të ruajtur habitatet natyrore në zonat Natura 2000 nëpërmjet përdorimit efektiv të tokës nga popullsia lokale, sipas traditave të së shkuarës, dhe jo si një "peizazh muze" i menaxhuar nga autoritetet e ruajtjes së natyrës.



Rrieti - NATYRA 2000



Në kullotat e braktisura dhe me vegetacion të dendur u hoqën fillimisht shkurret dhe ferrat. Pas këtyre masave fillestare, vijoi menaxhimi intensiv e i vazhdueshëm (kositje të përsëritura, kullotje nga delet) për të konsoliduar pastrimin fillestar. Pas rreth dy sezonesh, pra nga viti i tretë pas prerjes së shkurreve, toka mundi të integrohet sërish në përdorim bujqësor – por si tokë e përdorur ekstensivisht (kositje, kullotje), sipas skemave agro-mjedisore. Projekti LIFE kontrakttoi fermerë dhe barinj vendas për të kryer punimet e pastrimit dhe garantuar kullotjen e vazhdueshme kudo që të ishte e mundur. Kjo kishte dy avantazhe:

- Duke u përfshirë, fermerët u ndërgjegjësuam për konceptet dhe vlerat e Natura 2000;
- Pagesa për punimet me kontratë ishte një e ardhur shtesë jo e pa rëndësishme, veçanërisht pasi punimet kryheshin shpesh në periudha të qeta, si dimri. Nga ana tjetër kjo rriti mbështetjen për ruajtjen e zonave Natura 2000.

#### 6.4.2 Përfshirja e Fermerëve

Megjithatë, restaurimi i kullotave të braktisura rezultoi një punë e kushtueshme dhe e mundimshme. Rrjedhimisht, projekti i dytë LIFE nisi një aksion për të ndaluar braktisjen e tokës në radhë të parë, çka nënkupton përfshirjen e tij në ekonominë, strukturën dhe praktikën e bujqësisë lokale. Në këtë aksion, Rezerva e Biosferës dhe autoriteti lokal bujqësor punuan ngushtë së bashku për të identifikuar problemet me të cilat përballeshin fermerët dhe për t'i ndihmuar ata të gjenin mënyra të reja dhe efektive për menaxhimin e kullotave.

Fillimisht u zhvilluan një sërë takimesh në të cilat fermerët u informuan për këto ide. Për shkak të pjesëmarrjes çuditërisht të lartë, u ngritën 5 grupe pune dhe jo 2 siç ishte parashikuar në fillim, secili i bazuar në një fshat bujqësor. Këto pesë grupe diskutuan problemet me të cilat ballafaqoheshin fermerët dhe kërkuan zgjidhje të dobishme si për fermerët ashtu edhe për ruajtjen e natyrës.

Një problem kryesor i ngritur nga fermerët në Rhön-in përfundimor është se fermat janë shumë të fragmentuara (mijëra parcela mesatarisht 0,5-1 ha secila) gjë që pengon zhvillimin e bujqësisë. Për më tepër, duke qenë se çmimet e qumështit dhe mishit janë të ulëta, ka një tendencë për të braktisur blegtorinë edhe në zonat e ulta. Rrjedhimisht ka më pak kërkesë për bar – çka e bën jo tërheqëse kositjen e livadheve malore, pavarësisht nga masat agro-mjedisore që i mbështesin kositje të tilla. Kështu, habitatet e Aneksit I të Direktivës së Habiteteve kërcënohen nga braktisja.

Duke iu përgjigjur shqetësimeve të grupeve të fermerëve për copëzimin e tokës, Ministria e Bujqësisë Bavareze në vitin 2002 siguroi grante për fermerët për t'i lejuar ata të shkëmbejnë tokën mes tyre në mënyrë joformale, në baza sezonale, pa pasur nevojë të kalojnë nëpër procedurat e komplikuar të shit-blerjes apo dhënies me qira. Në këtë mënyrë u bë e mundur që çdo fermer të kishte në përdorim





Rrjeti - NATYRA 2000



blloqe të konsoliduara të tokës në mënyrë të lehtë dhe joformale. Iniciativa të tjera që dolën nga grupet e fermerëve ishin edhe:

- organizimi i bashkësive të makinerive bujqësore dhe krahut të punës ku fermerët mund të shkëmbejnë ose grumbullojnë burime;
- Krijimi i një tufe të lopëve për mish, në pronësi të përbashkët të fermerëve në fshatin Fladungen, ku ushqimi i bagëtive në dimër përfshin barin e kositur nga kullotat, çka ofron një nxitje për të vazhduar kositjen e livadheve me bar.

Kontratat agro-mjedisore janë shtrirë tashmë gjerësisht në të gjithë rajonin Rhön. Deri në fund të projektit LIFE në 2002, kishte 3000 dele që kullosnin zona të mëdha të habitateve gjysmë-natyrore në Rhön. Megjithatë, për të gjetur një bazë shoqërore dhe ekonomike më tërheqëse për këtë menaxhim të vazhdueshëm, përtej pagesave nga masat agro-mjedisore, Rezerva e Biosferës, në sinergji të ngushtë midis LIFE dhe instrumenteve të tjera financuese të BE-së, nisi disa nisma në favor të përdorimit të tokës në mënyrë ekstensive e miqësore ndaj ruajtjes së natyrës.



#### 6.4.3 Krijimi i pikave të reja të shitjes së produkteve bujqësore

Rezerva e Biosferës shkoi një hap më tej në mbështetjen e këtyre fermerëve që ishin të gatshëm të menaxhonin habitatet gjysmë-natyrore të kullotave. Duke u mbështetur në fondet strukturore LEADER dhe Objektivin 5B (EAGGF), ajo realizoi një sërë projektesh për zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme për të organizuar therjen në fermë dhe përpunimin e mishit në produkte përfundimtare me vlerë të shtuar më të lartë, ndërtimin e stallave të deleve dhe sigurimin e dhomave frigoriferike, si dhe ngritjen e një dyqani në fermë për të shitur produktet direkt te konsumatorët.

Këto infrastruktura i lejuan fermerët të siguronin çmime dhe shitje më të mira për mishin e deleve të tyre, i cili gjithashtu u promovua si një produkt miqësor ndaj natyrës. Në vitin 2002, çdo fermer nga zonat e rehabilituara nga projektet LIFE, shiste rreth 70% të qingjave direkt në restorantet dhe hotelet e zonës me çmime mjaft të mira.

Më pas u krijua një rrjet kompanish partnere, brenda të cilit ato do të shkëmbejnë produktet dhe shërbimet e tyre. Deri në fund të projektit LIFE rreth 40 kompani ishin pjesë e këtij rrjeti, ku përfshiheshin ferma bujqësore, ndërmarrje hotelerie, restorante dhe ofrues të tjerë produktesh e shërbimesh (p.sh. një firmë e përpunimit të drurit). Si pjesë e kësaj nisme, hotelet dhe restorantet

lokale, anëtarë të rrjetit, do të angazhoheshin vetëm për të përdorur mishin e deleve nga zona e Rhön-it për menutë e tyre. Gjithashtu, u promovua fakti se duke zgjedhur pjatat që përmbajnë mish deleje Rhön, vizitorët ndihmojnë në ruajtjen e peizazhit që kanë ardhur për të shijuar.



Rrieti - NATYRA 2000



Pika më e fortë e kësaj nisme ishte vëmendja ndaj komunitetit lokal, veçanërisht fermerëve. Pa pjesëmarrjen e tyre aktive, mirëmbajtja afatgjatë e habitateve të rehabilituara falë fondeve të investuara nga LIFE-Nature do të ishte e pamundur. Megjithatë, ndryshe nga vullnetarët që vijnë në kampet e punës për të ndihmuar me punën e menaxhimit, fermerët kanë biznese për të drejtuar dhe kanë nevojë për të ardhura të mjaftueshme për të mbijetuar në treg dhe për të fituar jetesën.

Pra, përveç fillimit të programeve bujqësore, projektet shkuan një hap më tej për ta bërë përdorimin e tokës në përputhje me udhëzimet e Natura 2000 tërheqës për fermerët, duke investuar në infrastrukturë (pika therje dhe përpunim lokal, dhoma frigoriferike, dyqane në fermë) dhe rrjete (midis fermerëve dhe tregëtarëve lokalë, restorantet, hotelet) përmes të cilave produktet mund t'u shiten me çmime të mira direkt konsumatorëve, duke përdorur përfitimet si mbështetje për ruajtjen e natyrës.





Rrieti - NATYRA 2000



## 7 Praktikë më të mira (shkurt)

### 7.1 Menaxhimi i konflikteve midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj në NATYRA 2000

Ashtu si në vendin tonë, fermerët e vendeve të tjera evropiane, veçanërisht në zonat rurale dhe parqet kombëtare, kanë probleme me arinjtë dhe ujqërit që shkatërrojnë kosheret e bletëve apo bagëtinë e tyre. Një shembull i tillë vjen nga Greqia, ku vrasja e paligjshme e këtyre specieve përbën 25% të të gjitha ngordhjeve të ujqërve çdo vit. Ky mbetet kërcënimi i vetëm më i madh për të dyja speciet në këtë vend. Një projekt i financuar nga BE-ja u lançua për të gjetur rrënjën e problemit duke analizuar incidentet e kaluara brenda një numri zonash të NATURA 2000 dhe duke mbajtur diskutime kokë më kokë me fermerët. Si rezultat, projekti ishte në gjendje të lobonte për një përmirësim të ndjeshëm në skemat kombëtare të kompensimit për humbjen e bagëtive.

Megjithatë, kjo nuk është e gjithë historia. Të gjithë ranë dakord se zgjidhja më efektive do të ishte parandalimi i çdo dëmtimi në radhë të parë, prandaj u provuan masa të ndryshme me fermerët. Ato përfshinin ngritjen e gardheve elektrike rreth tokave bujqësore dhe koshereve, sigurimin e burimeve alternative të ushqimit për kafshët e egra, si pemët frutore të egra të mbjella në pemishte të braktisura dhe furnizimin e fermerëve me qen bari vendas për të mbrojtur kopetë. Të tre masat rezultuan të ishin parandaluese efektive dhe shumë të njohura për fermerët vendas. Në fund, në planin e zhvillimit rural është përfshirë edhe një mbështetje shtesë financiare për zbatimin e këtyre masave mbrojtëse në tokat e fermerëve. Tashmë është vënë re një rënie e vrasjeve të ujqërve dhe arinjve në zonat e projektit.

### 7.2 Kompanitë e energjisë elektrike punojnë për të ndihmuar në shpëtimin e shpendëve grabitqarë

Linjat e energjisë dihet se janë përgjegjëse për vrasjen e shpendëve të kërcënuar. Një shembull pozitiv se si kjo mund të shmanget vjen nga Spanja. Këtu shqiponja perandorake kërcënoheshin nga aksidentet me linjat e energjisë elektrike, ku përfundonin të goditur nga rryma elektrike pasi përplaseshin me linjat e tensionit të lartë. Për të adresuar këtë problem, qeveria rajonale po punon ngushtë me kompanitë e energjisë elektrike për të rregulluar mbi 350 km linja elektrike në zonat e NATURA 2000 në mënyrë që ato të bëhen të sigurta për shpendët. Që nga fillimi i këtij bashkëpunimi, ka pasur një rënie dramatike të numrit të vrasjes së shpendëve. Disa madje kanë filluar të bëjnë fole në kullat e larta të energjisë elektrike. Kompanitë e energjisë elektrike kanë rënë dakord që tani e tutje të kalojnë të gjitha kabllot e reja nën tokë.



Rrieti - NATYRA 2000



### 7.3 Ndërtimi i rrugëve

Ka shembuj brenda BE-së që tregojnë se disa praktika më të mira janë krijuar si rezultat i një procesi afatgjatë dhe jo gjithmonë të lehtë. I tillë është shembulli me ndërtimin e rrugëve, që doli të ishte një gabim i kushtueshëm sepse nuk u bë që në fillim në bashkëpunim me mbrojtësit e natyrës. Faktikisht, kur nuk u morën parasysh aspektet mjedisore, disa projekte të autostradave u ndaluan ose u vonuan nga OJQ-të dhe komuniteti lokal. Një shembull pozitiv se si kjo mund të shmanget vjen nga Austria, ku kompania e ndërtimit të autostradave ASFINAG përdor qasjen ndaj planifikimit dhe zhvillimit të projektit bazuar në pjesëmarrjen e publikut dhe planifikimin e integruar. Në përgatitjen e projekteve të saj të infrastrukturës, kompania tani fokusohet në tre elementë kyç: mbledhjen e informacionit cilësor në lidhje me ndikimet e mundshme në mjedis, si dhe në komunitetet pjesëmarrëse dhe palët e tjera të interesuara në një proces të mirëfilltë konsultimi që synon të adresojë të gjitha shqetësimet dhe të identifikojë opsionet më të mira që përfshijnë ruajtjen e natyrës dhe sektorët që ka të ngjarë të preken nga skema e propozuar (p.sh. urbanistët, autoritetet e ujit, bordet e turizmit) në fazat e hershme konceptuale, përpara se të vizatohen linjat në hartë. Në këtë mënyrë mund të krijohen situata "pozitive" ku zgjidhet një rrugë që shkakton dëmin më të vogël në mjedis. Është e vërtetë që kjo qasje kushton më shumë kohë dhe para në një afat të shkurtër, por shmang kostot shumë më të mëdha në planin afatgjatë, pasi projektet mund të ecin përpara siç janë planifikuar.